

TOMAS PIKETI

Dalja e Greqise
do ta "vdese"
fare Euron



GEORGE FRIEDMAN

Dy krizat e
medha te
Europes



ROBERT KAPLAN

Arti i
shmangies
se luftes

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al-Maj 2015

**Fundi i Britanisë
ashtu si e njohim**



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipërisë tuaj

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



Një prej “dënimeve” që merr kur refuzon të marrësh pjesë në politikë, është se përfundon duke u qeverisur nga ata që janë inferiorë ndaj teje.

Platoni

Vendi më i nxehtë në Ferr u është rezervuar atyre që qëndrojnë neutralë, në kohëra konflikti të madh moral.

Martin Luther King Jr.

Politika është luftë pa gjakderdhje, ndërkohë që lufta është politikë me gjakderdhje.

Mao Cedun

Njeriu është nga natyra një kafshë politike.

Aristoteli

Nëntëdhjetë përqind e politikanëve i japin dhjetë përqindëshit tjetër një reputacion të keq.

Henry A. Kissinger



Si do ta vulosë politika fatin e Greqisë

Ka një ironi të madhe: nëse politika e shtyn Athinën drejt daljes, gjeopolitika është e vetmja që e mban në klubin e Euros. Greqia ndodhet në qoshen strategjike juglindore të kontinentit evropian. Ballkani është një rajon ku presidenti rus, Vladimir Putin, ka përqëndruar përpjekjet e tij për të destabilizuar aleancën perëndimore. A mundet vërtetë Europa të lejojë që qeveria e Athinës të bjerë në krahët e Moskës? Cili do të ishte sinjali për pjesën tjetër të Ballkanit? Cfarë mund të themi për Qipron e ndarë? A do të ishte kostoja e lejimit të largimit të saj nga Euro, më e madhe se sa barra politike dhe financiare e mbajtjes zvarrë të Greqisë në Eurozonë?

PHILIP STEPHENS

Harrojini raportet e borxhit, ekuilibrat fiskalë, problemet e likuiditeteve dhe pjesën tjetër. Kriza e Greqisë ka qenë gjithmonë sa politike, aq edhe ekonomike. Tani, ka vetëm lidhje me politikën. Ekzistojnë dy teori në lidhje me qeverinë e Syrizas, të udhëhequr nga Alexis Tsipras. Njëra teori, paraqet një grup amatorësh që kanë kaluar muajt e fundit duke e zhytur Greqinë thellë e më thellë në një gropë ekonomike - e në të njëjtën kohë, duke çuar dëm besimin dhe vullnetin mirë të partnerëve të eurozonës. Teoria tjetër thotë se sjelljet e çuditshme të Ministrit grek të Financave, Yanis Varou-

fakis, janë një maskaradë politike e qëllimshme, e përlogaritur për ta çliruar Greqinë nga “prangat” e kredidhënësve të pamëshirshëm. Hipoteza e parë është më popullore. Mburrrjet dhe piruetat, intervistat në revistat plot shkëlqim, marksizmi studentor dhe dashuria për prozhektorët - të gjitha të çojnë tek një dështim kolosal nga ana e Varoufakisit, për të rrokut thellësinë e gjendjes së vështirë në të cilën ndodhet Greqia, apo ndjeshmëritë e partnerëve të saj evropianë. Në ndërkohë, dhjetëra miliona dollarë kanë ikur prej bankave greke, teksa qytetarët i kanë futur kursimet e tyre gjatë. Por, edhe teoria e komplotit ka mbështetësit e vet. Ata fillojnë me supozimin se askush nuk mund të jetë aq pa tru, sa janë shfaqur shpesh udhëheqësit e Syrizas. Qeveria e Tsiprasit e dinte që në krye të herës, se nuk mund të pajtonte premtimet që kish bërë brenda vendit, me detyrimet ndërkombëtare të Greqisë. Problemi ishte se grekët kishin votuar njëkohësisht për t’i dhënë fund programit të rreptësisë fiskale, dhe për të qëndruar në Euro. Duhej “prodhuar” një krizë, për të treguar se qeveria nuk kishte nga ia mban-te. Nga gjermanët, sigurisht. Unë jam i prirur drejt teorisë së parë, por kjo nuk ka rëndësi. Edhe në këtë orë të vonë, do të ishte jo e mençur të thoshim se një marrëveshje me kredidhënësit është absolutisht e pamundur. Politika në nivele të lartë kërkon herë pas here të thuash se derrat fluturojnë. Ajo që më befason, megjithatë, është se sa përpara ka shkuar biseda në kryeqytetet e tjerë evropianë. Tashmë po flitet për kaosin që do të pushtonte Greqinë, pas falimentit dhe daljes nga Euro. A do të ishte e menaxhueshme, apo BE do të mbetej me një shtet të dështuar?

Në “punë” janë dy impulse politikë. Më i dukshmi, pjesa tjetër e Eurozonës ka konkluduar se Athina nuk është në gjendje, ose nuk ka vullnet - ndoshta edhe të dyja - për të implementuar një program reformash ekonomike. Problemi nuk është aq shumë borxhi, as edhe ritmi i reduktimit të defiçitit, por refuzimi i Syrizas për të nisur reformimin e shtetit. Fjalët që përdoren më shpesh për të përshkruar qeverisjen në Greqi janë klientelizmi, korrupsioni, interesat specialë dhe favoritizmi. Pa një ribërje totale të kapaciteteve politikë dhe administrative të vendit, asnjë program ekonomik nuk mund të funksionojë.

Edhe partnerët e Greqisë kanë politikën e tyre. Konfrontimi në eurozonë përshkruhet më shpesh si një, mes Berlinit dhe Athinës. Wolfgang Schaeuble, ministri i financave i Gjermanisë, i jep besueshmëri kësaj ideje, me fërkimet e tij të shpeshtë me Varoufakisin. Megjithatë, “fajkonjtë” e vërtetë duhet të gjenden në Madrid, Lisbonë dhe Dublin. Këta shtete kanë ndier tashmë dhimbjen e programit të kursimit dhe reformave. Ata kanë nisur të shohin rreze drite. Udhëheqësit e trye politikë nuk shohin arsye përse Greqia duhet lënë të bëjë si të dojë. T’i bëhen lëshime tani Syrizës, thonë ata, do të legjitimonte populistët në vendet e tyre. Dhe ata kanë edhe zgjedhje përpara. Supozimi në shumë kryeqytete është se tani mund të jetë shumë vonë për të shpëtuar Greqinë. Dhe ata nuk janë të sigurtë nëse Syriza dëshiron të shpëtohet. Por pasojat e falimentit dhe daljes nga Euro do të ishin shkatërrimtare. Ekonomistët do t’ju thonë se përfitimi i madh prej rritjes së konkureshmërisë, që do të burojë nga zhvlerësimi i valutës, me

Konfrontimi në eurozonë përshkruhet më shpesh si një, mes Berlinit dhe Athinës. Wolfgang Schaeuble, ministri i financave i Gjermanisë, i jep besueshmëri kësaj ideje, me fërkimet e tij të shpeshtë me Varoufakisin. Megjithatë, “fajkonjtë” e vërtetë duhet të gjenden në Madrid, Lisbonë dhe Dublin. Këta shtete kanë ndier tashmë dhimbjen e programit të kursimit dhe reformave. Ata kanë nisur të shohin rreze drite

kalimin e kohës do të kompensojë krizën në standartet e jetesës. Megjithatë, këto lloj llogarish ngrihen mbi supozimin e një qeverie funksionale, me kapacitetin për të shfrytëzuar avantazhin.

Më shumë gjasa ka që ai do të çohet dëm, me rritje pagash dhe inflacion. Një opsion tani është që kredithënësit t'i ofrojnë një marrëveshje “merre ose lëre” Greqisë, të ngjashme me atë që i parashtruan Qipros - me pritshmërinë që Tsiprasi ndoshta do ta lërë. Megjithatë, pavarësisht gjithë frustrimit dhe fatalizmit që qëndron varur mbi negociatat, askush nuk është shumë i prirur që të shpallë përfundimin. Ka një ironi të madhe këtu: nëse politika e shtyn Athinën drejt daljes, gjeopolitika është e vetmja që e mban në klubin e Euros.

Greqia ndodhet në qoshen strategjike juglindore të kontinentit europian. Ajo ofron një portë hyrjeje për imigrantët dhe ata që kërkojnë strehim, të larguar prej zjarreve të Lindjes së Mesme, si dhe një pedanë potenciale për xhihadistët islamikë që kërkojnë të sjellin luftën e tyre në Europë. Ballkani është një rajon ku presidenti rus, Vladimir Putin, ka përqëndruar përpjekjet e tij për të destabilizuar aleancën perëndimore. A mundet vërtetë Europa të lejojë që qeveria e Athinës të bjerë në krahët e Moskës? Cili do të ishte sinjali për pjesën tjetër të Ballkanit? Cfarë mund të themi për Qipron e ndarë?

Këta janë mendimet që vërtiten në kokat e politikëbërësve, teksa Athina i afrohet datave të shlyerjes së borxheve. A do të ishte kostoja e lejimit të largimit të saj nga Euro, më e madhe se sa barra politike dhe financiare e mbajtjes zvarrë të Greqisë në Eurozonë? Këto janë çështje që duhet t'i zgjidhin krerë qeverish, dhe jo teknikienë. Sido që të shkojë, historia ka një fund të palumtur. Brenda apo jashtë Euros, me apo pa çlirim të mëtejshëm nga borxhet, Greqia mund të rimëkëmbet vetëm nëse fillon të ndërtojë një shtet modern europian.

FT



Historitë paralele të Athinës dhe Dublinit. Leksion “i pakëndshëm”

Ajo që po i ndodh Athinës – paaftësia për të modernizuar vendin – është tregues i një rreziku më të madh për Europën: i asaj që ndodh, kur një lëvizje populiste siguron mbështetje, e cila i lejon të influencojë zgjedhjet politike, apo edhe të marrë pushtetin. Ajo që bashkon Syrizan me partitë populiste që i afrohen pushtetit në Spanjë, Francë, Finlandë apo Holandë, është se, në dallim nga partitë e konsoliduara, këto nuk kanë pothuajse asgjë për të humbur, nëse kur të jenë në qeverisje, dështojnë: maksimumi do të kthehen atje ku ishin, në opozitë, apo drejt hiçit

DANILO TAINO

Kriza greke po provokon një shtrembërim optik, pothuajse psikedelik, në shumë pjesë të Europës. Hedh rrënjë ideja që politikat e adoptuara për t’iu përgjigjur krizës që shpërtheu në Athinë në vitin 2010, e që vazhdoi në vende të tjerë, kanë dështuar tërësisht. Është një bindje kjo, e cila qëndron në themel të propagandës së të gjithë partive të ashtuquajtura populiste – në të majtë e në të djathtë – që kohët e fundit kanë rregjistruar fitore elektorale, dhe në rastin e Greqisë, kanë marrë pushtetin. Kush kujton situatën në tregjet dhe në ekonomitë e Europës në vitet dramatikë 2011 dhe 2012, nuk mund të mos shohë një realitet të ndryshëm. Si dhe të vendosë transformimin e krizës, nga financiare në politike,

në një perspektivë të ndryshme.

Vendet që iu nënshtruan një programi formal shpëtimi – Greqia, Irlanda, Portugalia – apo programi ndihmash për vështirësitë e sistemit bankar – Spanja – kanë adoptuar të gjithë këshillat e trojkës, e formuar nga BE, BQE dhe FMN: një kombinim i reformave strukturore dhe shëndoshjesh së bilanceve publike, në këmbim të mbështetjes financiare. Rezultati nuk është vetëm fakti që faza më eakute e krizës, e cila në verën e tre viteve më parë ishte ende dramatike, tashmë është një kujtim: merita e qetësisimit të tregjeve i shkon ndërhyrjes së famshme të Mario Draghit, në të cilën presidenti i Bankës Qendrore Europiane siguroi që Euro nuk do të dështonte. Ashtu sikurse edhe ekonomitë që i nënshtroheshin “kurës”, e cila nuk ka qenë thjeshtë rreptësi fiskale, po e rimarrin veten.

Komisioni Europian parashikon që Irlanda do të rritet këtë vit me 3.6%, pasi u rrit me 4.8% në vitin 2014: me një papunësi të parashikuar në nivelin 9.2% në vitin 2016, nga një nivel 13.1% që ishte dy vjet më parë. Ekonomia e Portugalisë është rikthyer në pozitive: më shumë se 0.9% në vitin 2014, dhe këtë vit do të arrijë 1.6%, me papunësinë që bie me tre pikë, në krahasim me 16.4% që ishte në 2013-ën. Si Dublini, edhe Lisbona, që në kulmin e krizës nuk mundeshin të tërhiqnin para prej investitorëve, janë rikthyer në tregje dhe kanë dalë prej programit të ndihmave. Spanja këtë vit do të rritet me 2.8% dhe të papunët – një problem strukturor i vjetër për spanjollët – do të bien me pothuajse 4 pikë në krahasim me 26% që ishte dy vjet më parë papunësia. Vitin e kaluar parashikohej që edhe vetë Greqia do të rritej me 2.9% në vitin 2015, me papunësinë e cila kish nisur të binte që në vitin 2014, në krahasim me 27.5% që ishte në 2013. 12 muaj më parë, Athina ia kish dalë në mënyrë të jashtëzakonshme që të rikthehej në tregje dhe të siguronte para, qoftë si shtet sovran, qoftë përmes bankave të saj. Nëse, pas fitores në zgjedhje në 25 janar të këtij viti, Syriza do të kish bërë ndonjë reformë të majtë – të detyronte evazorët e mëdhenj fiskal që të paguanin taksat, të merrte ndonjë masë për lehtësimin e krijimit të vendeve të punës – sot, udhëheqësi i saj, Alexis Tsipras do të ishte Kryeministri i rimëkëmbjes dhe i rikthimit të Greqisë në ekonomitë europiane dhe globale. Por, në vend të kësaj, ai rrezikon kaosin. Ajo që po i ndodh Athinës – paaftësia për të modernizuar vendin – është tregues i një rreziku më të madh për Europën: i asaj që ndodh, kur një lëvizje populiste siguron mbështetje, e cila i lejon të influencojë zgjedhjet politike, apo edhe të marrë pushtetin.

Ajo që bashkon Syrizan me partitë populiste që i afrohen pushtetit në Spanjë, Francë, Finlandë apo Holandë, është se, në dallim nga partitë e konsoliduara, këto nuk kanë pothuajse asgjë për të humbur, nëse kur të jenë në qeverisje, dështojnë: maksimumi do të kthehen atje ku ishin, në opozitë, apo drejt hiçit. Kanë lindur pa amigdalë, ajo pjesë e trurit që është përgjegjëse për frikën: mund të luajnë me fatin, sepse nuk rrezikojnë që të paguajnë pasojat e veprimeve të tyre. Për këtë arsye, në përgjithësi, kanë programe qeverisës psikedelike por jo të besueshëm, të paaftë të përballen me realitetin dhe ta ndryshojnë.

Jo se në Europë gjërat shkojnë mirë. Më e keqja e krizës ekonomike ndoshta ka kaluar, por problemet mbeten: rritja është e ulët, produktiviteti nuk përmirësohet, shoqëria plakët, inovacioni vuan, papunësia mbetet e lartë. Recesioni i madh ka lënë plagë që do të duhen vite të shërohen.

Kështu që, është e kuptueshme që në shumë shtete, qytetarët të shprehin vota proteste. Por, përgjigjet ndaj këtij kalimi të vështirë dihen: reforma kombëtare për të bërë ekonomitë dinamike dhe prodhuese pasurie, dhe reforma të BE. Sa për populizmat: testi i tyre i acidit po kryhet këto orë, në Athinë.

Corriere della Sera



Thomas Piketi: Dalja e Greqisë do ta “vdesë” Euron!

Ekonomisti i njohur për qëndrimet kundër masave shtrënguese, thotë se vendet e mëdha të BE-së, nuk duhet t’u japin leksione të tjerëve

Prej kohësh, Tomas Piketi paralajmëron mbi paqëndrueshmërinë e situatës për shoqërinë greke dhe Evropën. Ekonomisti majtë, shumë kritik ndaj politikës ekonomike të presidentit socialist Fransua Holond, autori i librit bestseller në mbarë botën “Kapitali në shekullin e XXI-të”, thotë se e cilëson “të pabesueshme që sot t’i shpjegohet Spanjës dhe Greqisë që zgjidhja e vetme, është të paguajnë të gjitha borxhet deri në euron e fundit, kur ne e dimë se kjo nuk do të funksionojë”.

Dhe për të frenuar ndjenjën e pakëndshme, se lehtësimi i borxheve do të ishte një dhuratë shumë bujare për Greqinë e evazionit fiskal, Piketi nën-

vizon se vendet e mëdha evropiane, nuk kanë kualifikimin e duhur për të dhënë leksione: Masat që sot i imponojnë Athinës, nuk i patën aplikuar – për fat të mirë – për veten e tyre, kur ishin edhe më keq se kaq. Pas luftës, Franca dhe Gjermania, kishin një borxh publik që e tejkalonte me 200 përqind Prodhimin e Brendshëm Bruto, por në vend të përdorimit të masave shtrënguese, aplikuan inflacionin dhe ristrukturimin e borxhit. Insistimi evropian kundër Greqisë të bën të qeshësh, thotë Piketi. Dhe pavarësisht se prej disa muajsh, shprehen se një dalje e Athinës nga eurozona, nuk do të ketë pasoja serioze për pjesën tjetër të BE-së, Piketi e gjykon këtë ngjarje të mundshme, një katastrofë për të gjithë zonën e monedhës së përbashkët.

Cilat do të ishin pasojat e falimentimit të Greqisë?

Një dalje e Greqisë nga Eurozona do të kishte pasoja të pallogaritshme. Kriza e besimit, që po minon zonën e Euros prej 5 vitesh, do të merrte përmasa edhe më të mëdha. Gjatë çdo procesi zgjedhor, të gjithë do të pyesnin veten se cili do të jetë vendi i ardhshëm, që do të dalë nga Eurozona. Një dalje e Athinës, mund të përfaqësonte “vdekjen” e Euros.

Në përbashkëtimin e ashpër, mes kryeministrit grek Cipras dhe kreditorëve ndërkombëtarë, cilat mund të jenë lëshimet e arsyeshme nga të dyja palët? Greqia gjendet aktualisht në situatën e një tepricë të lehtë primare, ose thënë ndryshe grekët paguajnë pak më shumë taksa, sesa përfitojnë në kuadër të shpenzimeve publike. Është e arsyeshme të kërkosh prej tyre të mbajnë këtë prirje, por për ta bërë këtë, duhet arritur sa më shpejt një marrëveshje. Problemi është se marrëveshjet e vitit 2012, parashikonin një tepricë primare gjigante ose rreth 4 përqind të PBB-së për dekadat e ardhshme! Për krahasim, buxheti i përgjithshëm i të gjitha universiteteve në një vend si Greqia apo Italia, është vetëm 1 përqind e PBB-së. Marrëveshjet e 2012-ës duhet të rinegociohen, dhe sa më shpejt të ndodhë kjo, aq më mirë do të jetë.

Mendoni se është i pashmangshëm një ristrukturim i borxhit grek?

Historia ekonomike është e mbushur me ristrukturimet e borxhit publik apo dhe fshirjen e tyre, si në rastin kur Gjermania përfitoi pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1953, aleatët hoqën dorë nga pretendimet për borxhin që u kishte Gjermania këtyre vendeve, dhe kjo bëri që vendi të investojë në rritjen ekonomike, infrastrukturë dhe aftësim profesional. Ne duhet të bëjmë të njëjtën gjë tashmë në nivel evropian, duke bashkuar të gjitha borxhet publike të Eurozonës në një fond të përbashkët, prej nga ku mund të fillojë ristrukturimi.

Cilat mendoni se janë përgjegjësitë e Trojkës (FMN, BQE, BE) në njërën anë, dhe qeverive greke nga ana tjetër?

Qeveritë greke para vitit 2010, mbajnë një përgjegjësi të madhe për gjendjen aktuale të vendit. Por të kërkosh, që pasojat e kësaj krahure të paguhen nga brezat e rinj për dekada të tëra, kjo nuk është zgjidhje. Nga viti 2010 e këtej, Gjermania, Franca dhe Italia i kanë imponuar Greqisë një kurë masash financiare shtrënguese, të cilat e kanë përkeqësuar më tej situatën.

Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar pranoi se e kishte nënvlerësuar ndikimin e masave të diktura ndaj Greqisë në drejtim të recesionit ekonomik. Problemi është se vendet e mëdha evropiane refuzojnë të pranojnë gabimet e tyre dhe pjesën e tyre të përgjegjësisë.

Zakonisht prirjen të fajësojnë Gjermaninë...

Nuk është vetëm Berlioni, që ka një rol në gjithë këtë. Italia, Franca, Greqia dhe Spanja tashmë janë thirrur të paraqesin propozime për rithemelimin demokratik të Evropës. U takon atyre të veprojnë, për të mundësuar që politikën e kursimit të përkrahen vetëm nga një pakicë, në kuadër të një Dhome Parlamentare të Eurozonës, që është e domosdoshme, por që mbetet për t'u ndërtuar. /CDS



Dy krizat e mëdha të Evropës

GEORGE FRIEDMAN

Evropa është duke përjetuar dy kriza të ndërlidhura mes tyre. E para është ajo e Bashkimit Evropian. Blloku e filloi si një sistem i integritit ekonomik, por që kishte për qëllim të ishte më shumë se kaq: do të ishte një institucion, që do të krijonte Evropianët.

Dallimet kombëtare midis vendeve evropiane janë reale dhe kanë dëshmuar të jenë destabilizuese, qëkur Evropa përbëhet nga kombe me interesa të ndryshme dhe armiqësi historike. Projekti i BE-së nuk kishte ndërmend t'i shfuqizonte këto kombe; dallimet dhe tensionet ishin shumë të thella. Por ai synonte t'u vishte identiteteve kombëtare, një identitet evropian. Do të kishte sërish kombe, dhe ato do të ruanin tek e fundit sadopak sovranitet, por qytetarët e tyre gjithnjë e më shumë do ta shihnin veten si evropianë. Për rrjedhojë, identiteti evropian do të krijonte një kulturë të përbashkët, si dhe do zvogëlonte dallimet e shteteve.

Nxitja për të gjithë Evropën, ishte zhvillimi dhe paqja. Bashkimi Evropian, do të krijonte prosperitet të vazhdueshëm, i cili nga ana e vet do të eliminonte rrezikun e konfliktit. Në këtë kuptim, sfida në Evropë, ishte se zhvillimi është në rastin më

të mirë ciklik, dhe për më tepër rajonal.

Evropa po lufton përmes integritimit, pasi pa zhvillim të përgjithshëm, joshja e evropianëve dhe braktisja e provincializimit të kombeve, do të dështojë. Prandaj, kriza e Bashkimit Evropian e përqëndruar në Gadishullin Evropian, është një nga forcat destabilizuese. Unë përdor termin 'Gadishull Evropian', për të treguar rajonin që shtrihet në perëndim të një vijë të hequr, nga Shën Petersburgu në Rostov mbi Don, duke u bërë gjithnjë e më i ngushtë, deri sa të arrijë në gadishullin Iberik dhe Oqeanin Atlantik. Franca, Gjermania dhe Italia janë në gadishull, me lumenjtë e sistemuar të Danubit dhe Rinit. Në vijën e lindjes është Rusia. Ndërsa gadishulli është i lidhur ngushtë me oqeanet, dhe për këtë arsye është i angazhuar në tregtinë globale, Rusia nuk ka dalje në det. Është një vend shumë i izoluar, me portet e saj të largëta në Paqësor, dhe ngushticat turke, si të vetmet rrugë për në Mesdhe, dhe kalesat në Balltik dhe Arktik, të penguara nga akulli dhe moti i keq.

Në gadishull, veçanërisht kur lëvizni në perëndim, cilido nga vendet, nuk është më shumë sesa disa qindra milje larg nga deti. Rusia, e ndërvarur nga transporti tokësor, që është më i vështirë dhe më i kushtueshëm sesa tregtia detare, ka prirje të jetë dukshëm më e varfër sesa gadishulli. Kriza e dytë qëndron tek struktura strategjike e Evropës. Duke lënë mënjanë ishujt e largët, dhe gadishujt e tjerë që përbëjnë Europën, problemi i vjetër i kontinentit është marrëdhënia ndërmjet një toke të madhe e të unifikuar, por të varfër, të dominuar nga Rusia, dhe gadishullit të pasur, por shumë më tepër të fragmentuar. Midis Ruisë dhe gadishullit qëndron një tokë kufitare, që asokohe ishte nën kontrollin e Ruisë apo një fuqi gadishullore ose, më shpesh, e ndarë. Kjo tokë kufitare, është herë pas here e pavarur dhe sovraane, por kjo është diçka e rrallë. Më shpesh, madje edhe kur është sovraane, ajo ndodhet në sferën e ndikimit të vendeve të tjera.

Kjo hapësirë ka dy nivele: e para në lindje, dhe më të largëtat janë Bjellorusia, Ukraina dhe pjesë të Ballkanit, ndërsa e dyta përbëhet nga Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria, Rumania dhe Bullgaria. Pas Luftës së Dytë Botërore, pushteti i Ruisë shtrihet në nivelin e dytë dhe më gjerë. Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, këto vende u bë sovraane, dhe ndikimi i gadishullit lëvizti në drejtim të lindjes, me dy institucione gadishullore, Bashkimi Evropian dhe NATO-s, të përfshira në grupin e dytë.

Ndërsa kjo ka ndodhur, dhe vendet balltike janë të përfshira në nivelin e dytë, Bjellorusia dhe Ukraina, u bënë veçanërisht një vijë ndarëse dhe një zonë tampon. Dy gjëra duhet të theksohen këtu. Së pari, ishte ekzistenca e Bashkimit Evropian, ajo që i dha Gadishullit një kornizë për zgjerimin në lindje. Në shumë aspekte, NATO-ja u bë agonizuese, teksa e humbi toruan pas Luftës së Ftohtë. Megjithatë, në vitet pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, Bashkimi Evropian ishte më dinamik, dhe dukej i përcaktuar për të bashkuar gadishullin. Ndërsa fuqia sovjetike u rrëzua, dhe fuqia evropiane dukej e predipozuar të zgjerohej, Bashkimi Evropian ofroi një kuadër unik për zgjerimin, dhe një opsion tërheqës për kombet e reja sovraane në kufi me të.

Rusia ishte në një gjendje sistematike shoku në vitet '90. Ajo ishte një periudhë e kaosit, e karakterizuar nga humbja e plotë, si e kontrollit ashtu edhe planeve. Dukej gati sikur Rusia ishte pa ndjenja. Nga pikëpamja evropiane dhe amerikane, ky ishte një normalitet i ri për Rusinë. Në fakt, ishte e pashmangshme që kjo të ishte thjesht një gjendje kalimtare. Institucioni i vetëm, që historikisht e ka mbajtur Rusinë të bashkuar, ishte policia sekrete

Së dyti, Rusia ishte në një gjendje sistematike shoku në vitet '90. Ajo ishte një periudhë e kaosit, e karakterizuar nga humbja e plotë, si e kontrollit ashtu edhe planeve. Dukej gati sikur Rusia ishte pa ndjenja. Nga pikëpamja evropiane dhe amerikane, ky ishte një normalitet i ri për Rusinë. Në fakt, ishte e pashmangshme që kjo të ishte thjesht një gjendje kalimtare. Institucioni i vetëm, që historikisht e ka mbajtur Rusinë të bashkuar, ishte policia sekrete. Në një vend të varfër, me komunikime dhe një rrjet transporti modest, aftësia e qendrës për të kontrolluar periferinë është e kufizuar. Institucioni i një sistemi efikas të sigurisë, do të ishte e domosdoshëm në qoftë se Rusia duhet të shmangte përçarjen. Nga epoka e carëve e deri në ditët tona, kjo është ajo që e ka mbajtur Rusinë së bashku.

E gjitha kjo bëri, që kur shoku i parë i rënies kaloi, aparati i sigurisë do të rimerete veten dhe stabilizonte Rusinë. Nuk ishte personaliteti i Vladimir Putinit, që pati rëndësi; nëse nuk do të ishte ai, një tjetër udhëheqës do të kishte dale në skenë, dhe do të pengonte shpërbërjen e ekonomisë dhe shtetit rus.

Ky proces i pashmangshëm, bëri që Rusia të ristrukturojë veten, brenda kufijve të pushtetit të saj të zvogëluar. Ringritja, përfshiu një përpjekje si për të stabilizuar ekonominë e vendit, ashtu edhe ripohuar interesat e saj gjeopolitike, fillimisht në Kaukaz dhe pastaj në Ukrainë. Pa një zonë tampon në gadishullin lindor, Rusisë i mungon thellësia strategjike, që e ka shpëtuar atë nga pushtimet gadishullore në të shkuarën.

Prandaj, çdo përpjekje për të stabilizuar Rusinë, do të kërkonte një vështrim të perëndimit drejt vijës kufitare, ku niveli i dytë ka humbur plotësisht, dhe ku madje edhe vendet balltike u bënë pjesë e sistemit gadishullor, me një interpretim të zgjerimit lindor si një kërcënim ekzistencial për Rusinë.

Pozicioni i Bashkimit Evropian, ishte se integrimi në rritje i kontinentit, ishte diçka krejtësisht e mirë.

Ky mund të ketë qenë qëllimi subjektiv i evropianëve, por rusët panë diçka që ata kurrë nuk e kishin vërejtur më parë: institucione të integruara, me ambicje në mesin e disa anëtarëve për t'u shndërruar në një federatë të komb- shteteve, dhe që mund të shkojë edhe përtej ekonomisë.

Ka patur diskutime mjaft të gjera, mbi sistemet e mbrojtjes evropiane dhe federatën, që kanë shkaktuar shqetësim në Moskë. Pa një zonë tampon, një Evropë e bashkuar dhe me një qëllim të ndryshuar, mund të përbëjë një kërcënim ekzistencial për Rusinë. Ky ishte veçanërisht rasti, edhe për shkak se Shtetet e Bashkuara,



kanë mbajtur një aleancë të paqartë me evropianët, duke ndarë frikën e përbashkët kundër ringritjes së Moskës.

RINGJALLJA E RUSISË DHE KRIZAT E EVROPËS

Në vitin 2008, ndodhën dy ngjarje kritike. Së pari, dhe më pak e rëndësishmja, ishte lufta e Ruisë me Gjeorgjinë, që dëshmoi - më shumë sesa mund të kërkojë realiteti - rishfaqjen e Ruisë si një fuqi domethënëse dhe të aftë rajonale. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, kriza ekonomike e shkaktuar nga kriza amerikane e tregut të pronave të paluajtshme, që çoi në fragmentimin gradual të unitetit evropian, duke shkaktuar një mospërputhje masive interesash.

Zhvendosja lindore e ndikimit evropian, e mbështetur nga Shtetet e Bashkuara, ka vazhduar, pavarësisht krizës. Rusët, ishin të detyruar t'i kundërviheshin, duke qenë më pak të shqetësuar për pasojat. Në thelbin e saj, kriza evropiane ishte e thjeshtë. Gjermania kishte ekonominë e katërt më të madhe në botë. Ajo nxjerr mbi 50 për qind të të ardhurave të saj nga eksportet, gjysma e të cilave shkon në zonën europiane të tregtisë së lirë.

Përveç kësaj, duke përdorur ndikimin e saj të konsiderueshëm, euro maksimizoi interesin e ekonomisë europiane në tërësi.

Interesat e Gadishullit Evropian, ndahen në 4 pjesë: ato të Evropës gjermanike (Gjermania, Austria, dhe në një farë mase Republika Çeke); Evropa mesdhetare; kufiri lindor i Bashkimit Evropian; dhe pjesa tjetër e Evropës veriore. Gjermania ka interesa të mëdha tek Bashkimi Evropian, dhe zona e saj të tregtisë së lirë. Është një komb në vetvete i dobët, sikurse janë të gjitha vendet që janë të varura nga eksportet

Duke pasur parasysh madhësinë e ekonomisë gjermane, është vetëm një zmadhim të vogël, të pohohet se nevojat e saj ekonomike përcaktojnë ekonominë e Evropës.

Euro, ka ndihmuar në stabilizimin dhe mbështetur rritjen e ekonomisë gjermane, ashtu siç kanë bërë edhe rregullat e krijuara nga Brukseli. Kjo sjellje e kufizuar e sipërmarrësve u vërejt tek vendet, ku pagat e ulëta duhet të kenë qenë një shtysë për rritjen ekonomike. Pëkundrazi, këto vende u shndërruan në një mundësi të artë për investimet gjermane.

E gjitha kjo ishte e durueshme para vitit 2008, për shkak se anëtarët e BE-së kishin nënshkruar Traktatin e Mاستrihtit në vitin 1992, e cila i çoi drejt monedhës së përbashkët, ata kishin parë një periudhë të jashtëzakonshme zhvillimi. Mbi një baticë në rritje, pluskojnë të gjitha anijet. Por në vitin 2008, një krizë financiare rutinë (nga pikëpamja e një shekulli) shkatërroi strukturën e gadishullit. Gjatë çdo krizë ekonomike, pyetja më e rëndësishme, është se kush do të mbajë barrën, kreditorët apo debitorët? Përgjithësisht, Evropa është ndarë përgjatë këtyre linjave.

Gjermania ishte kreditori më i madh i gadishullit. Evropa Jugore, borxhliu më i madh i saj. Duke lënë mënjanë pozat morale, mbi atë se kush kreu padrejtësi ndaj kujt, gjermanët këmbëngulin tek masat e kursimit. Institucionet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, janë rreshtuar me Gjermaninë.

Interesat e Gadishullit Evropian, ndahen në 4 pjesë: ato të Evropës gjermanike (Gjermania, Austria, dhe në një farë mase Republika Çeke); Evropa mesdhetare; kufiri lindor i Bashkimit Evropian; dhe pjesa tjetër e Evropës veriore. Gjermania ka interesa të mëdha tek Bashkimi Evropian, dhe zona e saj të tregtisë së lirë. Është një komb në vetvete i dobët, sikurse janë të gjitha vendet që janë të varura nga eksportet.

Mirëqenia e Gjermanisë, varet nga aftësia për të shitur produktet e saj. Nëse bllokohet nga një depresion ekonomik në mesin e konsumatorëve të saj, apo prej pengesave politike ndaj eksporteve, Gjermania do të përballet me një ekonomi në rënie, që mund të krijojë kriza të brendshme sociale. Gjermania duhet të bëjë gjithçka që mundet, për të disiplinuar Bashkimin Evropian, pa i motivuar anëtarët e saj për t'u larguar. (Çështja nuk është largimi nga eurozona, por duke vendosur kufizime mbi eksportet gjermane.)

Kështu Evropa gjermanike, është duke ecur në një linjë pozitive. Është motori ekonomik i Evropës, por edhe shumë i pasigurtë. Duke pasur parasysh fragmentimin në Bashkimin Evropian, ajo duhet të arrihet nga të tjerët, veçanërisht Rusia, përta i përket alternativave. Moska, nuk përfaqëson një alternativë në vetvete, por në një situatë të keqe, mund të jetë pjesë e zgjidhjes, në rast se Gjermania mund të gjejë një rrugëdalje. Natyrisht, ky është skenari më i keq, por rasti më i keq është shpesh realiteti për Evropën në një periudhë afatgjatë. Evropa Jugore, është duke kërkuar një rrugë që do t'i lejojë të shpëtojë nga masat katastrofike të kursimit, në një Evropë që duket e paaftë, për të gjeneruar rritje domethënëse ekonomike.

Në qoftë se kjo nuk i shpëton kombet evropiane jugore, ato duhet të vendosin, në terma të thjeshtë, nëse është më mirë të shpallin falimentin, apo të paguajnë një më një borxhet. Ndërsa Gjermania është e prirur për momentin, të mos i detyrojë ata drejt kësaj pike, ky skenar po shfaqet më vete.

Ky është realiteti themelor i Evropës: Gjermania dëshiron të ruajë zonën e tregtisë së lirë, por pa thithjen e borxheve të këqija të Evropës. Europa Jugore, ka nevojë të zhvendosë barrën e vet dhe përfundimisht të rishikojë realizueshmërinë e tregtisë së lirë, duke qenë se ende nuk e ka bërë këtë.

Ashtu siç ka kufizime mbi tregtinë bujqësore, pse të mos krijohet i njëjti ambient që gjermanët gëzuan në vitet '50, kur ata ishin në gjendje të mbronin veten nga eksportet industriale amerikane, duke rritur industrinë e tyre, përmes një konkurrence minimale?

Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, ndodhen në një pozitë të ndërlikuar me Bashkimin Evropian, pasi në përgjithësi janë anëtarë pa qenë ende pjesë e eurozonës. Por për shumicën prej tyre, çështja e fuqisë dhe synimeve të Ruisë, është më e rëndësishme sesa kriza greke. Në Lindje, ekziston vetëdija se Europa nuk shënuar asnjë progres drejt një politikë të jashtme dhe të mbrojtjes të përbashkët, dhe se Bashkimi Evropian nuk mund t'i mbrojë dot kundër Ruisë.

Këto vende janë gjithashtu të vetëdijshme, se as NATO-ja s'mund t'i mbrojë ato, përveçse përmes përfshirjes amerikane, e cila po vjen shumë e kujdesshme dhe me një rritje të ngadaltë. Pastaj është pjesa e katërt e Evropës, veçanërisht Franca, e cila mendohet të jetë e barabartë me Gjermaninë në Bashkimin Evropian, por që në fakt ka pësuar një mpakje dhe tërheqje dekadat e fundit, ashtu siç bëri në shekullin XIX. Franca, është pjesë e Evropës Jugore si Greqia, së bashku me papunësinë e lartë që e shoqëron jugun e kontinentit. Dhe së bashku me evropianët e kësaj ane, që po përballen me probleme në Mesdhe dhe në Afrikën e Veriut, së bashku me problemet e tyre ekonomike, Franca nuk është tërhequr në lindje, as nuk është e kënaqur me politikat gjermane, por ajo është duke u tërhequr në drejtime të shumta, lidhur me çështjet ekonomike dhe strategjike.

Një kontinenti i ndarë

Një kontinent i tërhequr në drejtime të shumta, është përshkrimi më i mirë mbi Bashkimin Evropian, dhe ai që i jep rusëve një farë lehtësime. Rënia e çmimeve të naftës, dhe paaftësia e Ruisë për t'i kthyer të ardhurat nga nafta në një ekonomi të larmishme e të qëndrueshme, në thelb po i kufizon faktorët që përcaktojnë fuqinë e Moskës.

Në Ukrainë, rusët po përjetojnë problemet e dyfishta të dështimit të shërbimeve inteligjente, si dhe kufizimet e forcave të saj ushtarake. Shërbimet sekrete, nuk

arritën të zbulojnë apo të menaxhojnë në kohë ngjarjet në Ukrainë, nga parashikimi i rënies së qeverisë tek kuptimi se nuk do të kishte kryengritje të përgjithshme në Ukrainën Lindore.

Ushtria ruse nuk ka pushtuar asgjë, ndonëse Moska në një farë mase kontrollon ende rebelët në lindje. Rusia ishte i pranishme në Krime në bazë të një traktati, dhe forcat e saj minimale dhe operacionet në Lindje nxorrën në pah si synimet e saj aggressive, ashtu edhe dhe kufijtë e fuqisë së saj. Rusët nuk bënë dhe aq mirë në këtë fushatë, dhe sipas mendimit tim nuk do të mund të fillojnë një pushtim të suksesshëm të Ukrainës si një e tërë, duke patur parasysh kufizimet e tyre mbi logjistikën dhe aftësitë e tjera.

Por rusët u shpëtuan nga fragmentimi i gadishullit. Evropiano- lindorët kërkuar disa veprime përfundimtare nga Evropa. Asgjë nuk ndodhi. Sanksionet shkak-tuan dhimbje, por ato nuk e diktuan politikën strategjike të Ruisë. Kështu, në atë masë që vija kufitare ka një mbrojtës, kjo nuk është Evropa, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjermanët nuk kanë dëshirë ta përjashtojnë tërësisht ndikimin e Ruisë mbi Ukrainën.

Francezët janë dobësuar në drejtime të shumta, dhe evropiano-jugorët nuk kanë asnjë interes në çështjet që s'kanë të bëjnë me BE, përveç emigracionit mysliman. (Kjo sfidë e fundit, i cila zgjidh problemin e mungesës së krahut të punës, por krijon probleme të emigracionit dhe rrezikun e terrorizmit, është një temë e rëndësishme, së cilës unë do t'i rikthehem në të ardhmen. Megjithatë, emigracioni mysliman, nuk kërcënon arkitekturën themelore të Evropës, sqarim që është qëllimi i një vlerësimi neto). Vlerësimi neto i Evropës, është që ndarja themelore e gjeografike e kontinentit mbetet në vend, dhe se Rusia ruan ende pozitën më të dobët. Megjithatë, forca e saj relative është rritur, me rritjen e interesave të kundërta në kuadër të Bashkimit Evropian, dhe shqetësimi kryesor i Moskës në lidhje me Kontinentin, nuk është Evropa por Shtetet e Bashkuara.

Prandaj, kriza në Bashkimin Evropian, do të përcaktojë më gjerësisht situatën në Rusi, dhe se kriza themelore duket e pazgjidhshme brenda kornizës aktuale të diskutimit. Debati do të zhvendoset nga borxhi dhe pagesat e tij, tek krijimi i një Bashkimi Evropian të qëndrueshëm, në të cilën Gjermania nuk mund të eksportojë gjithçka që dëshiron, por duhet të pranojë kufizime, në dobi të zhvillimit të afërt të partnerëve të saj. Derikur politika ta mundësojë këtë proces, fragmentimi i gadishullit do të rritet, dhe bashkë me të, fuqia relative e Ruisë do të rritet, duke shkaktuar tërheqjen e Shtetet e Bashkuara.

GEOPOLITICAL WEEKLY



Fundi i Britanisë, siç e njohim ne

NGA ANNE APPLEBAUM

Këto zgjedhje do të mbahen mend si ato që i shpëtuan karrierën Dejvid Kameronit, kryeministrit britanik, i cili vetëm dy muaj më parë, po e mendonte seriozisht mundësinë e daljes nga politika. Ato të 7 Majit do të kujtohen ndërkaq si zgjedhjet që befasi i dhanë fund karrierës së liderit të Partisë Laburiste, Ed Milibandit, i cili i kishte gdhendur plot besim premtimet e tij elektorale, vetëm një javë më parë.

Mbi të gjitha, do të ndërmenden si zgjedhjet, mbi të cilat u gabua nga ana e çdo lloj sondazhi: Të gjithë flisnin me tmerr për një parlament të ndërvarur, koalicionet të pakicave dhe ndërhyrjeje. Por shumë kohë pasi këto drama të ndryshme të jenë harruar, këto zgjedhje mund të mbahen mend edhe si procesi që shënoi fillimin e fundit të Britanisë së Madhe, të paktën në formën që ne e njohim aktualisht.

Sigurisht kjo mund të shënojë vërtetë, fillimin e fundit të Mbretërisë së Bashkuar, bashkimit të katër vendeve - Uellsit, Anglisë, Irlandës së Veriut dhe Skocisë - stabiliteti i së cilës nuk ishte sfiduar seriozisht prej një kohe të gjatë. Së pari, Partia

Kombëtare Skoceze, e cila bën thirrje haptazi për shkëputjen e saj nga unioni, ka fituar 56 nga 59 vendet e Skocizë në parlamentin britanik, duke fshirë mbështetjen që gëzonin në këtë vend, si Laburistët ashtu edhe Liberal Demokratët, ndërsa në disa vende shënuan një rritje elektorale prej 30 apo edhe 40 përqind.

Mbi të gjitha, është e qartë se jo të gjithë në Londër, janë thellësisht të mërzitur nga ky lajm. “Gjithsesi, unë kurrë nuk ndjehesha realisht një “britanik” - më tha një mik mbrëmjen vonë, natën e zgjedhjeve. “Unë ndihem anglez”. Dhe unë mendoj, se nuk ishte i vetmi.

Papritmas, një vizion mbi një të ardhme të ndryshme ka dalë në pah, sidomos për një pjesë të caktuar konservatorësh anglezë: të sertë, të vështirë, ndoshta ata mund të sundojnë pjesën tjetër të asaj që mbetet të jetë Britania e Madhe, për një kohë të pacaktuar.

Për lexuesit amerikanë, është e vështirë të kuptohet domethënia e kësaj situate: Imagjinoni që një parti teksane, që lufton për pavarësinë e shtetit nga SHBA, pas viteve të tëra fushatë, të rrëmbejë çdo vend në Kongres që i takon Teksasit. Dhe tani imagjinoni ata pak njerëz në pjesën tjetër të vendit - ndoshta në Partinë Demokratike – që pas shumë viteve kundërshtim mbi kauzën e teksanëve, më në fund të fillojnë të mendojnë, se shkëputja e tyre në të vërtetë nuk mund të jetë aq e keqe, dhe duke filluar të llogarisin avantazhet zgjedhore në përputhje me rrethanat e reja.

Këto zgjedhje, mund të jenë fillimi i fundit të Britanisë së Madhe siç ne e njohim sot, edhe në një tjetër kuptim.

Në vitin 2013, Kameron premtoi se në rast se rizgjidhej në zgjedhjet e ardhshme, do të mbante një referendum për anëtarësimin e Britanisë në Bashkimin Evropian. Ai premtoi gjithashtu, disi më turbullt, se së pari do të “rishikonte” anëtarësimin.

Edhe sot askush nuk e di, se çfarë do të thotë kjo e fundit, ndërsa vetë Kameron nuk e shpjegoi kurrë atë. Ai as nuk u kërkoi kurrë aleatëve ose partnerët evropianë, për ta ndihmuar në këtë proces, dhe ky nuk është momenti më i mirë për ta filluar. Pjesa tjetër e liderëve të Evropës, janë të përfshirë në negociata të ndërlikuara financiare me Greqinë, po përforcojnë një strategji përkundrejt Rosisë, përballen edhe me një krizë të madhe të emigracionit të paligjshëm në brigjet jugore – ndaj nuk janë kolektivisht entuziastë, për nisjen negociatave të dhimbshme e të gjata me Britaninë. Por, pavarësisht se çfarë dëshiron pjesa tjetër e Evropës, kjo çështje është tashmë një domosdoshmëri në qendër të politikës së jashtme të Britanisë. Në praktikë, kjo do të thotë se diplomatët britanikë, nuk do të ketë kohë për t’u shqetësuar në lidhje me Rusinë apo Libinë në vitet e ardhshme, pasi ata do të jenë të përqendruar mbi traktatet e BE-së. Në samitet e unionit, britanikët do të duan të flasin për rolin e Britanisë në Evropë, dhe jo mbi rolin e Evropës në botë, apo krizat e Evropës në kufijtë e saj jugore dhe lindore. Ky vështrim i drejtuar nga jashtë, Britania e angazhuar plotësisht që “grushton mbi peshën e saj”, ka shkuar tashmë shumë larg, dhe jo të gjithë në Londër janë shumë të keqardhur mbi rrjedhën që kanë marrë gjërat.

Kameron, ka qenë më pak i interesuar në politikën e jashtme sesa çdo ministër

Këto zgjedhje, mund të jenë fillimi i fundit të Britanisë së Madhe siç ne e njohim sot, edhe në një tjetër kuptim. Në vitin 2013, Kameron premtoi se në rast se rizgjidhej në zgjedhjet e ardhshme, do të mbante një referendum për anëtarësimin e Britanisë në Bashkimin Evropian. Ai premtoi gjithashtu, disi më turbullt, se së pari do të “rishikonte” anëtarësimin

kryeministër britanik i dekadave të fundit. Partia e tij, sapo ka drejtuar fushatën më “ishullore” zgjedhore, që dikush mund të kujtojë, dhe ai sapo është shpërblyer me një fitore të bujshme, duke vepruar pikërisht kështu. Votuesit folën, dhe për konservatorët anglezë, mesazhi erdhi me zë të lartë dhe i qartë: Pa Skocinë, botën e jashtme, ata do të bëjnë vetëm mirë.

Ata gjithnjë do të kenë Londrën, me një nga sektorët më fitimprurës financiarë në botë; gjithmonë do të ketë Anglinë, me disa nga fshatrat më të gjelbër në botë; dhe ata do të kenë kujtimin e një historie madhështore - dhe ndoshta kjo është e mjaftueshme.

*** Shënim: Anne Applebaum është Drejtore e Programit “Global Transitions” në Institutin Legatum në Londër. /“Uashington Post”**



Tradhëti dhe tradhëtarë: Heshtja e Merkelit për skandalin e përgjimeve

KLAUS BRINKBÄUMER

Bota e politikës është e mbushur me rrëfime për sekrete dhe tradhëti, heshtje kolektive dhe diskrecion të individëve. Me rrëfime për besim dhe mosbesim. Bota e errët e spiunazhit nuk është e ndryshme - sekretet dhe tradhëtitë e saj janë legjendare. Por tradhëtia e Sigmar Gabrielit bën dallim.

Zëvendës kancelari i Gjermanisë deklaroi kohët e fundit se Angela Merkel e kishte siguruar dy herë që NSA dhe agjencia e zbulimit të jashtëm e Gjermanisë, BND, nuk kishin spiunuar asnjëherë kompani gjermane.

Në fakt, në vitin 2008, amerikanët nisën të mos u përmbahen marrëveshjeve dhe të shkojnë shumë larg - shumë, shumë larg. Ata spiunuan gjigandin e aviacionit, Airbus, mes të tjerëve. Në gusht të vitit 2013, Angela Merkel i kërkoi shefit të Kabinetit të asaj kohe, Ronald Pofalla, që të deklaronte se NSA “nuk po bënte asgjë që dëmtonte interesat e Gjermanisë”. Në fakt, Kanceleria dinte më shumë se kaq. Por Merkel e nuk ndërmoi asnjë veprim, duke zgjedhur që të lundrojë përmes

kësaj situate, duke mos thënë asgjë. Afro dy vjet më parë, pasi dolën në sipërfaqe informacionet e parë të nxjerrë nga Eduard Snouden, ajo tha se nuk dinte asgjë për se bëhej fjalë. Mesazhi që ajo ka përcjellë që nga ajo kohë, është se gjithçka është teknike dhe në të vërtetë, aspak e rëndësishme.

Strategjia e kancelares e pati efektin e dëshiruar. Publiku e pa atë si viktimë. Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013 duhej të ishin dominuar nga skandali i NSA-së, por Merkeli doli triumfante, e paprekur. Gazetat si konservatorja Frankfurter Allgemeine Zeitung shkruajtën në mënyrë naive se ndodh që shërbimet e fshehtë spiunojnë - dhe që, ç'mund të bëjmë, thjeshtë na duhet një shërbim i fortë zbulimi.

Por shërbimet e zbulimit dhe SHBA e kanë tepruar, tej mase. Merkeli mund t'u kishte bërë të qartë saktësisht se deri ku mund të vepronin, asnjë hap më shumë. Ajo mund të kishte mbëhstetur veprimtarinë e tyre, dhe në të njëjtën kohë të sigurohej që të mos dilte jashtë kontrolli. Me fjalë të tjera, ajo mund të kish marrë në dorë komandën.

Kur Angela Merkeli erdhi në detyrë në vitin 2005, ajo u betua që të mbrojë popullin gjerman. Është detyrë e saj të mbrojë kompanitë gjermane dhe publikun, kur shërbimet e fshehtë të SHBA veprojnë sikur Gjermania të mos ishte një shtet sovran. Por njerëzit në pushtet, shpesh herë nuk arrijnë të kuptojnë kur pikërisht ajo cilësi që i ka sjellë në majë, shndërrohet në dobësi, në rrezik, e madje edhe në shthurjen finale të tyre.

Merkeli ka prirjen të udhëheqë me dredhi. Asaj nuk i bëhet vonë për retorikën dhe konfrontimin, dhe i shmang vendimet e shpejtë. Këto mund të mos jenë cilësi të këqia, por ato nuk i shkojnë për shtet një kreu qeverie. Shumë prej paraardhësve të saj nuk donin asgjë më shumë se sa vendosmërinë dhe debatin. Për këtë arsye e kërkonin pushtetin, që në krye të herës. Por Merkeli duket se shqetësohet mos bën armiq duke folur troç, kështu që zgjedh të qëndrojë gojëmbyllur në kriza si kjo.

Tradhëtia më e madhe

Skandali i NSA fillimisht u shndërrua në një skandal të BND dhe në fund në një skandal të qeverisë gjermane. Skandali më i madh i kohës sonë. Një agjenci zbulimi amerikane, e zhytur në panik prej sulmeve terroristë të 11 shtatorit 2001, mblodhi çdo copë informacioni që të mundej, duke shkelur ligje amerikane, gjermane dhe ndërkombëtare, duke u sjellë si një shoqëri e fshehtë brenda një shoqërie të hapur. Kjo shkelje ligji u justifikua duke thënë se ishte në interes të sigurisë.

Por të dhënat e mbledhura përfshinin bashkëbisedime në Skype, emaile, kontakte dhe shumë të dhëna të tjera biznesmenësh, politikanësh, institucionesh të BE, dhe nëpunësish civilë që as nuk dyshoheshin për ndonjë gjë dhe që as nuk mundeshin të mbroheshin përballë sulmit të XKeystore, Prism dhe armëve të tjera të survejimit që janë përdorur nga NSA.

Me ekonominë, kërkimin, komunikimet dhe arshivat tashmë krejt të digjitalizua-

Skandali i NSA fillimisht u shndërrua në një skandal të BND dhe në fund në një skandal të qeverisë gjermane. Skandali më i madh i kohës sonë. Një agjenci zbulimi amerikane, e zhytur në panik prej sulmeve terroristë të 11 shtatorit 2001, mblodhi çdo copë informacioni që të mundej, duke shkelur ligje amerikane, gjermane dhe ndërkombëtare, duke u sjellë si një shoqëri e fshehtë brenda një shoqërie të hapur. Kjo shkelje ligji u justifikua duke thënë se ishte në interes të sigurisë

ra, veprimtaria e spiunazhit e NSA, e kryer me ndihmën e BND dhe dështimin e qeverisë gjermane, përmbledhet në një sulm ndaj lirisë sonë, vlerave dhe mënyrës sonë të jetesës. Një pranim i zonave gri i përket një vlerësimi realist të shërbimeve të fshehtë. Disa shkelje të ligjit janë të pashmangshme. Megjithatë, ata që punojnë në këto agjenci bëjnë dallime të kujdesshëm: shkelja e ligjeve të huaj në tokë të huaj - si ligjet e telekomunikacionit - mund të tolerohet ndonjëherë, sepse nuk mund të shmanget. Por shkelja e ligjit brenda vendit tënd, kundër popullit tënd, është një çështje krejt tjetër. Në vendet demokratikë, shërbimet e fshehtë e konsiderojnë këtë të papranueshme nga pikëpamja etike. Këtë e dinë mirë krerët e BND. Këtë e di mirë edhe Merkeli.

Por ndërkohë që ajo nuk po tghotë asgjë, Sigmar Gabrieli po flet. Ndoshta Gabrieli ka një ide të vagët se kush është në listën e “përzgjedhësve” që NSA i dha BND-së - parametrat e kërkimit që u përdorën për të filtruar interceptimet në Internet, telekomunikacion dhe të dhëna satelitore. Ai ndoshta ka menduar edhe nëse, dhe përse duhet të ndërmarrë rrezikun të shfaqet jobesnik, si dikush që e “godet” Merkelin kur kjo është “përtokë”. Ai zgjodhi të thyejë heshtjen sepse nuhati një shans për ta dëmtuar. Kjo nuk e bën as hero, as bilbilfryrës. Megjithatë, në këtë histori, janë të tjerë ata që bënë tradhëtinë më të madhe.

DER SPIEGEL



New York Times: Si i shërbeu “Kumanova” skandalit të përgjimeve

RICK LYMANMAY

Një skandal pothuajse surreal, me qindra-mijëra biseda të regjistruara fshehtës, ka kapur zyrtarë të qeverisë duke diskutuar gjithcka, që nga manipulimi i zgjedhjeve, deri tek mbulimi i vrasjeve.

Dy ministra dhe kreu i shërbimit të fshehtë kanë dhënë dorëheqjen. Mijëra vetë kanë dalë në rrugë, duke kërkuar largimin e qeverisë së krahut të djathtë. Dhe fundjavën që kaloi, 25 milje në veri të kryeqytetit, një shpërthim i papritur gjakderdhjeje la të vdekur tetë policë dhe 14 “terroristë”, si dhe të tjerët, që pyesin përse ndodhi, dhe përse tani.

Maqedonia, një vend me madhësinë pothuajse të Vermontit, me dy milion banorë, një temperament gjithnjë e më nacionalist dhe një histori jo më shumë se 24-vjecare, është në prag të krisjes. Ndërkohë që dikur shihej si një fanar ndricues mes ish shteteve komunistë, gjatë dekadës së fundit, Maqedonia ka rrëshkitur ngadalë drejt sundimit autoritar të një partie, e cila ka kufizuar të drejtat e medias, fuqizuar forcat e sigurisë, dominuar gjyqësorin dhe madje njëherë ka përjashtuar opozitën nga Parlamenti.

Dhe duke qenë se Maqedonia, me përzierjen e saj të paqëndrueshme etnike, qëndron në udhëkryqin e konflikteve të panumërt ballkanikë, si dhe në gjurmën e propozuar të një gazsjellësi të financuar nga Rusia, qeveritë perëndimore po i kushtojnë vëmendje të madhe kësaj vorbulle shqetësuese të ngjarjeve, si dhe teorive të komplotit që i rrethojnë.

“Njerëzit nuk qeshin shumë me teoritë e komplotit këtu në Ballkan”, thotë Marko Trosanovski, drejtor i Institutit për Demokraci “Societas Civilis”, një grup kërkimor joqeveritar në Shkup, kryeqyteti ivendit. “Ata kanë mësuar që t’i marrin seriozisht”.

...

Për tre muaj, opozita e majtë ka nxjerrë një seri të atyre që i quan “bomba”, copëza rregjistrimesh nga 670 mijë biseda të më shumë se 20 mijë telefonave, që janë rregjistruar fshehtas nga qeveria mes viteve 2007 dhe 2013 dhe që u janë dhënë, sipas tyre, nga nëpunës civilë patriotë.

Në shënjestër të rregjistrimeve kanë qenë gazetarë, klerikë, aktivistë dhe diplomatë të huaj, por edhe disa zyrtarë të lartë të qeverisë. Edhe vetë Gruevski, shumë i admiruar, por edhe një që ngjall shumë frikë, shfaqet në një bisedë, kur bisedon me një prej shënjestrave të rregjistrimeve.

Ka patur 31 publikime të tillë që nga muaji shkurt, dhe janë premtuar edhe disa të tjerë, përpara një mitingu të madh të parahsikuar për të dielën në Shkup. Deri tani, askush nuk ka mohuar që regjistrimet janë origjinalë, ndonëse qeveria këmbëngul se disa janë shkëputur nga konteksti dhe janë përpunuar.

Qeveria ka mohuar që të ketë bërë ajo regjistrimet, duke thënë se është vepër e një “shërbimi të fshehtë” të një vendi të huaj të paemër, që ka punuar me bashkëpunëtorë në Ministrinë e Brendshme për të rrëzuar qeverinë.

Gjashtë vetë, përfshirë ish kreun e shërbimit të fshehtë, janë burgosur dhe akuzuar për regjistrimin dhe nxjerrjen e kasetave dhe Zoran Zaevi, udhëheqësi i opozitës që ka udhëhequr fushatën e “bombave”, është akuzuar se ka kërcënuar me dhunë Gruevskin.

Por, po aq sa përmbajtja e bisedave, njerëzit janë befasuar nga toni i tyre, mënyra e pashpirt me të cilën ministra të qeverisë planifikojnë të ndëshkojnë armiqtë e tyre. Në një prej rregjistrimeve, kreu i policisë së fshehtë, që është edhe kushëri i kryeministrit, flet duke qeshur për përdhunimin në burg të një kundërshtari politik.

“Janë shumë vulgare”, thotë Jabir Deralla, presidenti i një grupi lokal të të drejtave të njeriut dhe monitorimit të zgjedhjeve, i quajtur Civil. “Se sa me lehtësi flasin për jetën dhe vdekjen e njeriut”.

As Gruevski dhe as ndonjë prej këshilltarëve të tij nuk pranuan të intervistohen. Por Aleksandër Pandov, një analist politik dhe ish deputet i partisë në pushtet, që e mbron me forcë qeverinë, ka shpjeguar pikëvështrimin e tij për skandalin. “Mund të dëgjosh dicka që është ndoshta vulgare, por jo provë e një krimi”, thotë ai. “Ka shkurtime të bisedave, gjëra të nxjerra nga konteksti. Ne nuk e dimë nëse disa prej gjërave që diskutohen kanë ndodhur vërtetë”.

Pandovi thotë se mënyra për të ecur përpara, është që ata që janë kapur duke bërë komente të papërshtatshëm të largohen nga qeveria, cdokush që gjendet fajtor të shkojë në burg, dhe Gruevski të qëndrojë në pushtet. “E gjithë situata po shkon

Për tre muaj, opozita e majtë ka nxjerrë një seri të atyre që i quan “bomba”, copëza rregjistrimesh nga 670 mijë biseda të më shumë se 20 mijë telefonave, që janë rregjistruar fshehtas nga qeveria mes viteve 2007 dhe 2013 dhe që u janë dhënë, sipas tyre, nga nëpunës civilë patriotë

drejt përmbylljes”, tha Pandovi.

Për momentin, opozita ka marrë kurajë. Në një intervistë... Zaevi la të kuptohet se mund të përdoren kordonë njerëzorë për të rrethuar ministri të rëndësishme si dhe bllokuar ura, dhe se protestat do të vazhdojnë. “Do të përdorim sistemin e Gandit”, thotë ai. “Do e bëjmë gjithë procesin absurd”.

Dorëheqja e ministrave të transportit dhe të brendshme si dhe kreut të shërbimit të fshehtë nuk e ndryshon planin, thotë Zaevi në një postim në Facebook. Madje, këto konfirmojnë ato që ka thënë opozita dhe nevojën për të vazhduar.

“Nuk është koha për të festuar”, tha Zaevi. “Eshtë vetëm një hap përpara drejt fundit të sundimit të Gruevskit”.

Ndërkohë, shfaqja e parë e atyre që qeveria i quan “terroristë shqiptarë” ndodhi muajin që kaloi, kur një grup u tha se kish marrë një kullë kufitare në kufirin me KOSOVËN dhe kish marrë për pak kohë peng rojet maqedonase. Ky rajon ka qenë terren i luftimeve të rëndë, ku u përfshinë nacionalistë shqiptarë në vitin 2001, por që atëherë është qetësuar.

Shumë kritikë të qeverisë e konsideruan të dyshimtë, si dhe një mënyrë për të larguar vëmendjen nga skandali i përgjimeve, por zyrtarë të qeverisë thanë se ishte një rrezik real nga një grup i mirëstërvitur shqiptarësh etnikë.

Por episodi i javës që kaloi, në lagjen e trimave të Kumanovës ishte ndryshe. Qyteti u rrethua dhe të shtënat mund të dëgjoheshin gjatë gjithë fundjavës. Në fund, sipas zyrtarëve, më shumë se 30 rebelë nga Kosova dhe Maqedonia iu dorëzuan policisë. Gruevski tha se grupi po planifikonte një sulm ndaj ndërtesave publike dhe qendrave tregtare në Maqedoni, duke shpresuar të destabilizojnë qeverinë, si dhe bëri thirrje për dy ditë zi kombëtare. Opozita i pezulloi përkohësisht protestat. Por dyshimet mbetën, se kjo ishte e orkestruar, ose e shfrytëzuar, për të larguar vëmendjen nga skandali.

Në një deklaratë të përbashkët, Ambasada e SHBA në Shkup, NATO, Bashkimi Europian dhe OSCE e quajtën “fenomen të izoluar” dhe i bënë thirrje qeverisë të merrej me krizën e saj politike si dhe të realizonte ndryshimet aq të nevojshëm...

Marrë me shkurtime nga The New York Times



Si e humbën rusët luftën

NGA MIKHAIL SHISHKIN

Babai im shkoi në luftë si vullnetar në moshën 18-vjeçare. Ai ishte një marinar nëndetëseje në Detin Balltik. Kur isha i vogël, jetonim në një bodrum në Arbat, në qendër të Moskës. Varur në mur mbi shtratin tim, ishte një fotografi e nëndetëses së tij “Shchuka”. Unë kam qenë tmerrësisht krenar që babai im kishte një nëndetëse, dhe përherë e kopjoja atë fotografi në fletoren time të shkollës. Çdo vit më 9 maj, Dita e Fitores në Rusi - që shënon përvjetorin e ditës kur kapitulloi Gjermania naziste në vitin 1945 - babai im do të shkonte tek dollapi për të marrë uniformën e tij të marinarit, e cila kërkonte mjaft kujdes për ta rregulluar, në atë trup tashmë me një bark të harkuar, dhe vendoste në të medaljet që kishte marrë. Ishte tepër e rëndësishme për mua, të isha krenar për tim atë: Kishte patur një luftë, dhe babai im e kishte fituar atë!

Kur u rrita, e kuptova se në vitet 1944- 1945, babai im kishte fundosur anijet që po evakuonin civilët gjermanë dhe trupat nga Riga e Letonisë dhe Talini i Estonisë. Qindra, në mos mijëra, njerëz gjetën vdekjen në ujërat e Balltikut - akte për të cilat, babai im ishte dekoruar me medalje. Ka kaluar një kohë e gjatë qëkurse kam qenë krenar për të, por unë nuk e gjykoj. Ishte kohë lufte.

Im atë luftoi të keqen e fashizmit, por u shfrytëzua nga një e keqe tjetër. Ai dhe miliona ushtarë sovjetikë, marinarë dhe aviatorë, skllavër virtualë, nuk i sollën botës çlirim, por një tjetër skllavëri. Populli sakrifikoji gjithçka për fitoren, por frytet e këtij triumfi ishin më pak liri e më shumë varfëri.

Babai im ishte 6-vjeç kur u arrestua gjyshi. Një djalë dëshiron të jetë krenar për babain e tij, por i ati i tij quhej armik i popullit. Gjyshi im u zhduk në Gulag. Kur filloi lufta, popullsia e përndjekur dëgjonte nga altoparlantët thirrjen: “Vëllezër dhe motra!”. Themeli i sundesve të Rosisë, qëndron tek mënyra sesi ata përfitojnë nga emocioni i shquar i njeriut: dashuria për atdheun dhe gatishmëria për të sakrifikuar gjithçka për të.

Kështu, babai im shkoi në luftë për të mbrojtur atdheun e tij. Ai ishte ende një adoleshent kur shkoi në det, nën terrorin e vazhdueshëm se mos mbytej në atë arkivol çeliku. Ai pra, përfundoi duke mbrojtur regjimin që i vrau babanë. Fitorja nuk u dha skllavërve asgjë, përveç një ndjenje madhështie të perandorisë së zotërisë së tij.

Fitorja e madhe, vetëm sa e përforcoi skllavërinë e tyre të madhe.

Pas luftës, babai filloi të pinte. Të gjithë shokët e tij marinarë, vepruan kështu. E çfarë mund të bënin tjetër? Gjatë epokës së Gorbaçovit, ne kaluam ditë të vështira, ndërsa babai, si një veteran, merrte një racion që përfshinte artikuj nga Gjermania. Për të, kjo ishte një fyerje personale. Ai dehej dhe ulërishte: “Por ne fituam!” Pastaj shtrihej dhe fillonte të qante.

“Më thuaj” - vazhdonte të pyeste ai, ndërsa unë nuk shihja askënd të cilit t’i drejtohej - “e fituam apo e humbëm luftën?”. Në vitet e fundit të jetës, ai e shkatërroi veten duke pirë pafundësisht vodka. Ai ishte i fundmi nga brezi i tij: të gjithë shokët e tjerë marinarë, kishin vdekur me kohë. Trupi i tim eti u dogj në krematorium së bashku me uniformën e tij të marinarit. Ai ndoshta ishte i mallur, për të parë shokët e tij të kohës së luftës.

Pyetja kryesore mbi Rusinë sot është: Në qoftë se atdheu është një përbindësh, duhet të duhet apo urrehet? Këtu çdo gjë ka ecur së bashku, në mënyrë të pandashme. Kohë më parë, një poet rus shkroi: “Një zemër e lodhur nga urrejtja s’mund të mësojë të dashurojë”.

Sigurisht, unë i uroj atdheut tim fitoren. Por çfarë do të përbënte në fakt, një fitore për vendin tim? Secila prej fitoreve të Hitlerit, ishte një humbje për popullin gjerman. Dhe shpartallimi përfundimtar i Gjermanisë Naziste, ishte një fitore për vetë gjermanët, të cilët dëshmuuan sesi një komb mund të ringrihet dhe jetojë si qenie normale njerëzore, pa dalldinë e luftës në kokat e tyre.

Megjithatë, sot Dita e Fitores, nuk ka të bëjë me fitoren e popullit, apo atë të babait tim. Nuk është një ditë e paqes dhe kujtimit për viktimat. Ajo është një ditë e shpatave që vringëlljnë vrullshëm, një ditë e arkivoleve të zinkut, një ditë agresioni, një ditë e një hipokrizie të madhe.

Rusëve, edhe një herë, u bëhet thirrje të luftojnë kundër fashizmit. Histeria patriotike në televizion është arma e mrekullueshme e regjimit. Në sajë të “kutisë së zombive”, popullsia tashmë ka një ide që duhet ta besojë mbi botën: Perëndimi dëshiron të na shkatërrojë, kështu që jemi të detyruar, si etërit dhe gjyshërit tanë, për një luftë të shenjtë kundër fashizmit, dhe duhet të jemi të përgatitur të sakrifikojmë gjithçka për fitoren.

Edhe një herë, udhëheqësit po e rishkruajnë historinë, dhe lënë në të, vetëm fito-

Pyetja kryesore mbi Rusinë sot është: Në qoftë se atdheu është një përbindësh, duhet të duhet apo urrehet? Këtu çdo gjë ka ecur së bashku, në mënyrë të pandashme. Kohë më parë, një poet rus shkroi: “Një zemër e lodhur nga urrejtja s’mund të mësojë të dashurojë”

re e lavdi luftarake. Ata kanë shtuar një kapitull në tekstet shkollore, mbi rikthimin e lavdishëm të Gadishullit të Krimesë. Një lumë histerie rrjedh nga ekranet televizive: “Rusia e Madhe”, “Mbroni gjuhën ruse”, “Mblidhuni rreth botës ruse” dhe “Ne do të shpëtojmë botën nga fashizmi”. Kushdo që kundërshton, është një “tradhtar i kombit”. Në vitin e 16-të sundimit të tij, Presidenti Vladimir Putin ka arritur gjithçka që një diktator mund të pretendojë. Populli i tij e do; armiqtë e kanë frikë. Ai ka krijuar një regjim, që mbështetet jo në paragrafët e thyeshëm të një kushtetute, por mbi ligjet e palëkundura të besnikërisë personale prej vasali ndaj sovranit të tij, nga fundi në krye të piramidës së pushtetit.

Babai im ishte një rus; nëna ime një ukrainase. Por regjimi i Putinit i ka vendosur popujt tanë kundër njëri-tjetrit. Nganjëherë mendoj se është më mirë që prindërit e mi nuk jetuan aq gjatë, sa të shihnin sesi rusët dhe ukrainasit po vrasin njëri-tjetrin. Është e pamundur të marrësh frymë, në një vend ku ajri është i mbushur me urrejtje. Historikisht, shumë urrejtje gjithmonë është pasuar, nga shumë gjak i derdhur. Çfarë e pret vendin tim? A mos vallë shndërrimi në një version gjigant të rajonit lindor ukrainas të Donbasit? Edhe një herë, diktatura po i bën thirrje qytetarëve të saj të mbrojnë atdheun, duke shfrytëzuar pa mëshirë propagandën e fitores në Luftën e Madhe Patriotike. Sundimtarët e Ruisë i kanë vjedhur popullit tim naftën, zgjedhjet, vendin e tyre. Dhe së fundmi, u kanë vjedhur edhe fitoren. Baba, ne e kemi humbur luftën.

Shënim: Mikhail Shishkin është një shkrimtar rus dhe autori, më së fundi, i përmbledhjes historike “Mësime kaligrafie”

NYT



Arti i shmangies së luftës

Pse është kaq e vështirë, për të mposhtur një armik që nuk do t'ju luftojë, dhe çfarë do të thotë kjo për strategjinë amerikane, nga Shteti Islamik tek Kina

NGA ROBERT D. KAPLAN

Skithianët ishin kalorës nomadë, që dominonin një hapësirë të gjerë, në stepën e Pontikut në veri të Detit të Zi, në Ukrainën e sotme dhe Rusinë jugore, nga shekulli VII deri në shekullin III Para Erës Sonë. Ndryshe nga popujt e tjerë të lashtë, të cilët nuk lanë asnjë gjurmë, skithianët vazhduan të sulmonin dhe tmeronin për një kohë të gjatë shumë popuj, edhe shumë kohë pasi ishin zhdukur. Herodoti i cilësoi ata si “shkatërruesit e gjithë Azisë”. “Ata jo vetëm që morën haraç prej çdo populli, por gjithashtu kryen bastisje dhe plaçkitën gjithçka që këta popuj kishin”. Napoleoni, duke qenë dëshmitar i gatishmërisë së rusëve për të djegur kryeqytetin e tyre, në vend se t’ia dorëzonin atë ushtrisë së tij, tha mendueshëm: “Ata janë Skithianë!”

Morali më trishtues për publikun modern, përfshin jo vetëm egërsinë e Skithianëve, por taktikat e tyre kundër ushtrisë pushtuese perse të Darit, në fillim të shekullin VI para Krishtit. Ndërsa reparti i këmbësorisë i ushtrisë së Darit, marshoi në lindje pranë Detit Azov, me shpresën për të ndeshur rrugës bandat skithi-

ane në një betejë vendimtare, këta të fundit u tërhoqën në thellësi të territorit të tyre të pafundëm.

Dari ishte në mëdyshje, ndaj e sfidoi mbretit Skithian, Idantirsus: Nëse ju e mendoni veten më të fortë, qëndroni dhe luftoni; nëse jo, dorëzohuni. Idantirsusi u përgjigj, se meqë njerëzit e tij nuk kishin as qytete, as toka të kultivuara dhe as një armik për të shkatërruar, ata nuk kishin asgjë për të mbrojtur, dhe në këtë mënyrë, nuk kishin arsye të zbrisnin në fushën e betejës.

Pëkundrazi, njerëzit e tij sulmuan, u përleshën dhe plaçkitën prapavijën persiane, pastaj u tërhoqën, dhe vazhduan kështu pa pushim. Çdo herë, grupe të vogla kalorësisish persianë ia mbathnin në kaos, ndërsa ballina e ushtrisë së Darit, e dobësuar siç ishte, vazhdoi të marshojë larg e më larg larg, nga linjat e saj bazë të furnizimit. Më në fund, Dari u tërhoq nga Skithia, në thelb i mundur, pa patur ndonjëherë mundësinë për të luftuar.

Me fjalë të tjera, vrasja e armikut është e lehtë; gjetja e tij është e vështirë. Kjo është aq e vërtetë sot se kurrë më parë; peizazhi i luftës tani është shumë më i gjerë e më i zbrazur nga luftëtarët, sesa ishte e gjatë betejave të Epokës Industriale.

Mësimet që lidhen me këtë situatë: mos shko në ndjekje të fantazmave, dhe mos u zhyt shumë thellë në një situatë, ku përparësia juaj qytetëruese, të ndihmon pak. Ose, siç thotë një fjale e urtë kineze e strategut luftarak të antikitetit Sun Tzu “Pala që e di se kur do të luftojë dhe kur jo, do të fitojë. Ka rrugë për të mos udhëtuar, ushtri për të mos u sulmuar, mure qytetesh për të mos sulmuar”.

Një rast i tillë, vjen nga ekspedita fatkeqe siçiliane në fund të shekullit V Para Krishtit, e rrëfyer nga Tukididi, në të cilën Athina dërgoi një forcë të vogël ushtarake në Siçilinë e largët në mbështetje të aleatëve atje, vetëm për t’u tërhequr thellë e më thellë në konflikt, derisa prestigji i gjithë perandorisë së saj detare, u bë i ndërvarur nga fitorja. Historia e Tukididit, është veçanërisht prekësë në vazhden e luftërave në Vietnam dhe Irak.

Me athinasit, ashtu si me Darin, njeriu habitet sesi obsesioni me nderin dhe prestigjin personal, mund të çojë një fuqi të madhe drejt një fatkeqësie. Imazhi i ushtrisë së Darit, që marshon drejt askundit nëpër një stepë të shkretë, në kërkim të një armiku që nuk shfaqet kurrë, është aq i fuqishëm, sa shkon përtej një simbolike të thjeshtë. Armiku juaj nuk do të përballet sipas kushteve tuaja, por vetëm sipas të tijave. Kjo është arsyeja pse lufta asimetrike, është e vjetër sa edhe historia. Kur kryengritësit vendosin autobomba dhe godasin marinsat dhe ushtarët amerikanë në qytetet irakiane, ata janë skithianë. Kur kinezët ngacmojnë anijen filipinase dhe kërkojnë pretendime territoriale me anijet e peshkimit, anijet e rojes bregdetare, dhe cisternat e naftës, të gjithë duke iu shmangur çdo përballeje me luftanijet e SHBA-së, ata janë skithianë.

Dhe kur luftëtarët e Shtetit Islamik, armatosin vetën me thika dhe telekamera, ata gjithashtu janë skithianë. Kryesisht për shkak të këtyre skithianëve, Shtetet e Bashkuara kanë një aftësi të kufizuar, për të përcaktuar rezultatin e shumë konflikteve, pavarësisht nga të qenit një superfuqi. Amerika po mëson një të vërtetë ironike mbi perandorinë: ti ekziston, duke mos luftuar çdo betejë. Në shekullin I pas Krishtit, Tiberi e ruajti Romën, duke mos ndërhyrë në konfliktet e përgjakshme shkatërrimtare, përtej kufirit të tij verior. Pëkundrazi, ai praktikoi një durim strategjik, edhe pse shihet masakrat. Ai i kuptoi kufijtë e fuqisë romake. Shtetet e Bashkuara, nuk i janë vënë pas bandave të luftës në Jemen, sikurse

***Me fjalë të tjera,
vrasja e armikut
është e lehtë; gjetja
e tij është e vështirë.
Kjo është aq e vërtetë
sot se kurrë më
parë; peizazhi i luftës
tani është shumë më
i gjerë e më i zbrazur
nga luftëtarët, sesa
ishte e gjatë betejave
të Epokës Industriale***

veproi Dari në Skithia, por herë pas here vrasin individë nga ajri. Por fakti që Uashingtoni përdor dronët, nuk është dëshmi e fuqisë, por e kufizimit amerikan. Administrata e Obamës, duhet t'i njohë këto kufizime, dhe të mos lejojë, për shembull që vendi të tërhiqet me thellë në konfliktin sirian.

Nëse SHBA-ja, ndihmon në rrëzimin e diktatorit Bashar Al-Asad të mërkurën, atëherë çfarë do të bëjë të enjten, kur të shohë se ka ndihmuar ardhjen në pushtet të një regjimi xhihadist sunit, ose të premtën, kur të fillojë spastrimi etnik i komunitetit alevit?


Ndoshta kjo është një betejë, që siç mund të përkufizonte Sun Tzu, nuk duhet të luftohet. Por Asadi ka vrarë dhjetëra mijëra, ndoshta më shumë njerëz, dhe është duke u mbështetur nga iranianët! E vërtetë, por mos harroni se emocioni, pavarësisht se drejtës që mund të ketë me vete, mund të jetë armiku i analizës.

Pra, si mund të shmangë SHBA fatin e Darit? Si të mos e humbasë krenarinë, ndërsa ende përmbush përgjegjësinë e saj morale, si një fuqi të madhe? Ajo duhet të përdorë vetëm përkrahjen e tërthortë kudo që mund të ketë rastin, madje edhe në mesin e kundërshtarëve. Nëse huthit e mbështetur nga iranianë janë të gatshëm të luftojnë Al-Kaedën në Jemen, pse duhet të kundërshtohet amerikanët?

Dhe në qoftë se iranianët, ndezin një fazë të re të luftës sektare në Irak, le të jetë një shthurje e tyre, pasi ata vetë nuk arrijnë të kuptojnë mësimin e Skithianëve. Ndërsa Lindja e Mesme po shpërthen, përmes viteve të konflikteve me intensitet të ulët, ndërmjet grupeve skithiane, le të jetë Turqia, Egjipti, Izraeli, Arabia Saudite, Irani, ato që të nxisin një ekuilibër jo të lehtë të pushtetit, dhe Shtetet e Bashkuara të mbeten një gjysmë hapi të tëhequr-kujdes, tek e fundit, nuk është e njëjta gjë si kapitullimi.

Së fundmi, le të kthehet SHBA tek rrënjët e saj, si një fuqi detare në Azi dhe një mbrojtëse e tokës në Evropë, ku ka më pak skithianë, dhe më shumë dashakeqës të zakonshëm. Skithianët janë ndëshkimi i drejtë i kombeve misionare, kombe që nuk njohin kufij. Sigurisht Amerika duhet të arrijë suksese, por jo si Dari duke e ekzagjeruar.

Shënim: Robert D. Kaplan autor i librit “Kazani i Azisë: Deti i Kinës Jugore dhe Fundi i një Paqësori të qëndrueshëm”, dhe një studiuës në Qendrën për Sigurinë e Re Amerikane. “The Atlantic”



Leksioni i Solzhenicinit: Kështu u rezistohet gënjeshtreve të pushtetit

Dhuna “plaket” po kaq shpejt, dhe pa kaluar shumë vite, nuk është më kaq e sigurtë në vetvete për t’u shfaqur, e për t’u bërë më e paraqitshme kërkon papushim një aleate, dhe kjo është Gënjeshttra. Në fakt, dhuna nuk ka mënyrë tjetër për t’u maskuar, përveç gënjeshtres, dhe gënjeshttra nuk mund të ketë jetëgjatësi, përveçse përmes dhunës. Dhe dhuna nuk ka nevojë që të bëjë të ndihet çdo ditë, në çdo sup, peshën e putrës së saj: ajo kërkon vetëm që ne t’i nënshtrohemi gënjeshtres, që të bëhemi përditë pjesëmarrës në gënjeshtër

ALEKSANDËR SOLZHENICIN*

Kemi humbur kaq në mënyrë të pakthyeshme njerëzillëkun, sa që për kafshatën modeste të ditëve të sotme, jemi të gatshëm të heqim dorë nga të gjithë parimet tanë, shpirti, të gjithë përpjekjet e paraardhësve tanë dhe nga mundësitë e fuqive tona - gjithçka, vetëm e vetëm për të mos e trazuar ekzistencën tonë të pasigurtë. Nuk dimë më se çfarë janë krenaria, qëndrueshmëria, një zemër e përvëluar. Nuk na tremb as vdekja bërthamore, lufta e tretë botërore (duhet të ketë patjetër një vrimë ku të fshihemi) - vetëm një gjëje ia kemi frikën: që të bëjmë ata

pak hapa që na ndajnë prej kurajos civile!

Vetëm e vetëm që të mos largohemi nga tufa, të shkojmë për hesapin tonë - sepse, po sikur, pastaj të gjendemi pa bukën e bardhë, ujëngrohësin me gaz, lejen e qëndrimit në Moskë? Ka një koncept në gjendje të na sigurojë një jetë të qetë, sa kohë që jetojmë, dhe që na e kanë ngulitur në të gjithë “salcat” e qarqeve të edukimit politik, deri sa na ka hyrë mirë në kokë: mjedisi, kushtet shoqërore, nuk dilet prej tyre, qenia përcakton ndërgjegjen. Atëherë, ky hyjmë ne? Ne nuk mund të bëjmë asgjë. Përkundrazi, mund të bëjmë gjithçka. Por preferojmë të gënjejmë vetveten, për të qenë të qetë. Nuk janë aspak “ata” fajtorët për gjithçka, jemi vetë ne, vetëm ne! Do të na kundërshtojnë: por në fakt, çfarë mund të bëhet konkretisht? Na kanë mbyllur gojën, nuk na dëgjojnë, nuk pyesin për mendimin tonë. Si të bëjmë për t’i bindur ata që të na dëgjojnë? Sido që të jetë, nuk ka asnjë mënyrë që t’i detyrojmë të ndërrojnë mendje. Gjëja më e natyrshme do të ishte që të mos i rizgjidhnim - po tamam, sikur në vendin tonë të kishte zgjedhje.

Pra, është një qark i mbyllur? Vërtetë nuk ka rrugëdalje? Dhe duhet të presim pasivisht që, nga hiçi, diçka të bëhet vetë? Por ajo gjëja që kemi përsipër nuk do të largohet kurrë vetë, nëse ne të gjithë do të vazhdojmë ta pranojmë, ta nderojmë dhe ta përforcojmë çdo ditë, nëse nuk vendosim t’i kundërvihemi, duke filluar aty ku është më e dobët. Nga gënjeshtër. Kur dhuna thyen konsorciumin paqësor njerëzor, fytyra e saj digjet prej sigurisë arrogante që shfaq, madje ulëret, sipas mësimëve të saj: “Unë jam dhuna! Largohuni, hapni rrugë ose do ju vë poshtë!” Por, dhuna plaket po kaq shpejt, dhe pa kaluar shumë vite, nuk është më kaq e sigurtë në vetvete për t’u shfaqur, e për t’u bërë më e paraqitshme kërkon papushim një aleate, dhe kjo është Gënjeshtër. Në fakt, dhuna nuk ka mënyrë tjetër për t’u maskuar, përveç gënjeshtres, dhe gënjeshtër nuk mund të ketë jetëgjatësi, përveçse përmes dhunës. Dhe dhuna nuk ka nevojë që të bëjë të ndihet çdo ditë, në çdo sup, peshën e putrës së saj: ajo kërkon vetëm që ne t’i nënshtrohemi gënjeshtres, që të bëhemi përditë pjesëmarrës në gënjeshtër - dhe kaq mjafton për të qenë të nënshtuar besnikë.

Pikërisht këtu gjejmë çelësin, që deri sot ne e kemi fshehur, por aq ka qenë kaq i thjeshtë për t’u gjetur, për çlirimin tonë: mospjesëmarrjen personale në gënjeshtër! Nëse gjithnjë e më shumë njerëz nuk do të duan të kenë të bëjnë me gënjeshtërën, ajo fillon të zhduket. Si një sëmundje ngjitëse, e cila ekziston sa kohë që ka njerëz për t’u infektuar. Nuk na kërkohet të zbresim në shesh, nuk jemi të pjekur sa duhet për të shpallur publikisht të vërtetën, për të shprehur me zë të lartë atë që mendojmë - nuk është për ne, ka shumë rrezik. Por të paktën të refuzojmë të themi atë që nuk mendojmë. të vetëdijësohemi për kufirin, përtej të cilit fillon gënjeshtër - të tërhiqemi nga ky kufi i gangrenizuar.

Atëherë, secili prej nesh duhet të gjejë kurajën dhe të zgjedhë: ose të qëndrojë shërbëtor i vetëdijshëm për gënjeshtërën, ose të vendosë që ka ardhur momenti të shkëputet, të bëhet një njeri i ndershëm, që meriton respektin e fëmijëve dhe bashkëkohësve...

Po, në fillim nuk do të jetë e lehtë. Dikush do të humbasë përkohësisht vendin e punës. Të rinjve që duan të jetojnë sipas të vërtetës, kjo do ua ndërlikojë shumë,

Kur dhuna thyen konsorciumin paqësor njerëzor, fytyra e saj digjet prej sigurisë arrogante që shfaq, madje ulëret, sipas mësimëve të saj: “Unë jam dhuna! Largohuni, hapni rrugë ose do ju vë poshtë!” Por, dhuna plaket po kaq shpejt, dhe pa kaluar shumë vite, nuk është më kaq e sigurtë në vetvete për t’u shfaqur, e për t’u bërë më e paraqitshme kërkon papushim një aleate, dhe kjo është Gënjeshtër

që në fillim, ekzistencën e tyre rinore: në fakt, edhe verifikimet me pyetje-përgjigje janë të mbushura me gënjeshtër, dhe duhet zgjedhur.

Nuk ka ditë, kur gjithësecilit prej nesh nuk na duhet të zgjedhim në cilin drejtim të shkojmë: drejt të vërtetës, apo drejt gënjeshtres, drejt pavarësisë së shpirtit, apo drejt servilizmit shpirtëror. Dhe kush nuk do të ketë kurajën e mjaftueshme për të mbrojtur shpirtin e tij, të paktën të shmangë mburrjen për idetë e veta progresiste, të mos lëvdohet me titujt e tij akademikë, artist i popullit, i merituar për këtë apo për atë, dua vetëm të rri ngrohtë dhe me barkun plot.

Për njerëz si ne, të mpirë prej mosveprimit, edhe kjo rrugë - më e moderuara mes formave të ndryshme të rezistencës - nuk do të rezultojë aspak e lehtë. Sidoqoftë, më e lehtë se sa të luajmë me zjarrin, apo edhe se sa një grevë urie: flakët nuk do të përfshijnë gjymtyrët, sytë nuk do të bëjnë grevë, dhe pakëz bukë e zezë e një gotë ujë i pijshëm, do të gjenden gjithmonë për familjen tënde. Ai popull i madh i Europës, që e kemi mashtruar dhe tradhëtuar - populli çekoslovak - a nuk na ka treguar ne, se një gjoks i dobët, mund t'u rezistojë edhe tankeve, nëse brenda tij rreh një zemër e denjë? Do të jetë një rrugë e mbushur me pengesa - megjithatë, do të jetë më pak e dëmshme nga të gjitha. Një zgjidhje jo e lehtë për trupin - por e vetmja për shpirtin. Një rrugë jo e lehtë - megjithatë, edhe tek ne ka njerëz, dhjetëra njerëz, që prej vitesh u përmbahen këtyre kriterëve, jetojnë sipas të vërtetës. Pra, nuk jemi të parët që i hyjmë kësaj rruge, por u bashkohemi atyre që e kanë bërë tashmë! Sa më të shumtë dhe të bashkërenduar të jemi në interpretimin e saj, aq më e kalueshme dhe e shkurtër do të na duket! Do të jemi me mijëra, nuk do të na e ulin kokën, as nuk do ta provojnë. Nëse bëhemi dhjetëra-mijëra, vendi ynë do të ndryshojë aq shumë, sa që nuk do ta njohim më. Nëse na pushton frika, të paktën të pushojmë së ankuari për ata që do të na e heqin edhe ajrin për të marrë frymë - jemi ne vetë që e bëjmë! Të përkulemi edhe më shumë, të presim si do të shkojë, dhe miqtë tanë biologjikë do të kontribuojnë që të afrohet dita kur do të mund të na lexojnë edhe mendimet dhe të riprogramojnë gjenet tona.

Nëse edhe këtë herë do të lejojmë të fitojë frika, do të thotë se jemi hiçë, se për ne nuk ka asnjë shpresë.

Pjesë nga shënimet e Solzhenicinit: "Të jetosh pa Gënjeshtër", që autori i ka shkruajtur në 12 shkurt 1974, në Moskë



Orekset territoriale të Kinës mund të provokojnë SHBA

NGA ROB GARVER

Qeveria kineze ndërmori një hap, për të cilin qeveria amerikane kishte kohë që paralajmëronte, kur publikoi një dokument që përshkruan strategjinë e saj të përgjithshme ushtarake. Megjithatë, ndërsa administrata Obama mund të jetë e kënaqur me një transparencë më të madhe nga Pekini, me siguri që Uashingtoni nuk u ngazëllye nga planet, që qeveria kineze përshkruan atje, veçanërisht qëllimin e deklaruar për të vazhduar ndërtimin e ishujve artificialë në Detin e Kinës Jugore.

Dokumenti ndërkohë theksonte, se ushtria kineze “nuk do të sulmojë, nëse ne nuk jemi të sulmuar, por ne me siguri do të kundërsulmojmë, në rast se sulmohe mi” dhe se “Kina nuk do të kërkojë hegjemoni apo zgjerim”, sipas “China Daily”. Këto garanci tingëllojnë mirë, por ka një problem në përkufizime, që i bën disa

nga premtimet e qeverisë kineze të pakënaqshme për fqinjët e saj, dhe në fakt edhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Përkufizimi i territorit sovran të Kinës – që do të thotë hapësira tokësore dhe detare, që ajo ka të drejtë të mbrojtë – nuk përputhet me konceptin që ka shumica e vendeve të tjera për territorin kinez. Kina ka qenë vazhdimisht duke krijuar atë, që pretendon se është territori i ri sovran në mes të Detit të Kinës Jugore, me rimarrjen e tokës nëpër shkëmbinj të nënujorë artificial, dhe u zgjeruar në ishuj gati të zhytur.

Ushtria kineze, ka instaluar porte dhe baza ajrore, si dhe ka filluar trajtimin e tyre si një territor sovran në lidhje me mbrojtjen ajrore dhe trafikun e anijeve. Kjo ka shtuar tensionet, në një rajon të shqetësuar tashmë nga rritja e mundësive globale të Kinës. Zona e diskutuar, është rreth 750 milje larg nga pjesa kontinentale e Kinës, dhe shumë afër brigjeve të një numri vendesh të tjera, duke përfshirë Vietnamin, Filipinet dhe Brunein.

Megjithatë, si një çështje e politikës, Kina pretendon të drejtat territoriale, mbi pjesën dërruese të ishujve në detin e Kinës Jugore. Rreth 5 mijë miliardë dollarë volum tregtar, kalon çdo vit nëpër zonën e kontestuar, duke ngritur shqetësime se ujërat që kanë qenë deri më tani lirisht të lundrueshme, mund të jenë subjekt i një përpjekje nga ana e Kinës, për të kontrolluar trafikun detar.

Shtetet e Bashkuara, kanë kundërshtuar me forcë ndërtimin e vazhdueshëm të ishujve artificialë nga ana e Kinës, dhe në javët e fundit ka qenë gjithnjë e më agresive në sfidimin e pohimit kinez se ato përbëjnë territorin sovran, hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale, të cilat duhet të respektohen.

Javën e shkuar, ushtria amerikane dërgoi një avion spiun, mbi disa prej territoreve të pretenduara nga Kina, duke shkaktuar reagimin e ashpër të Pekinit.

Publikimi i dokumentit strategjik të martën, zbuloi se Kina ka për qëllim jo vetëm të ruajë instalimet që ka aktualisht në Detin e Kinës Jugore, por synon edhe t'i zgjerojë më tej ato. Ajo planifikon të ndërtojë dy fare në rajon, të njohur si ishuj Spratli. Raporti kritikonte qeveritë e huaja, për “ndërhyrje” në punët e vendeve në rajon, dhe zbuloi se ushtria kineze ka për qëllim të marrë një rol më kategorik në mbrojtjen e interesave të Kinës në rajon.

Gjithashtu në mënyrë të qartë, dokumenti thekson se ushtria kineze do të ndryshojë pozicionin e saj në rajon, nga një rol kyç në mbrojtjen e territorit kinez, tek një rol i ri, në të cilën mbrojtja është e balancuar nga aftësia për të vepruar në mënyrë sulmuese. Shtetet e Bashkuara dhe fqinjët e Kinës në Detin e Kinës Jugore – veçanërisht Filipinet – kanë refuzuar kategorikisht të njohin pretendimet mbi ishujt, të cilat pretendohen si territore sovraane nga vende të shumta.

Një zëdhënës i Ministrisë kineze të Mbrojtjes tha të martën, se çështja ishte përtej mosmarrëveshjeve, duke theksuar se ndërtimi i bazave ajrore dhe objekteve të tjera ushtarake,

nuk ishte diçka e ndryshme nga ndërtimi i tyre në pjesën kontinentale kineze.

Natyrisht, kjo ngre çështjen nëse ishujt Spratli janë territore kineze. Ndërsa tensionet në rajon, vazhdojnë të rriten, një editorial i një gazetë shtetërore kineze paralajmëronte të hënën, se nëse Shtetet e Bashkuara e ndryshojnë pozicionin e tyre, konflikti ndërmjet dy vendeve mund të jetë i pashmangshëm.

“The Fiscal Times”



Koha që në Lindjen e Mesme të rikthehet imperializmi

Perandoria mund të ketë dalë mode, por historia tregon se i vetmi opsion tjetër, është lloji i kaosit që po shohim sot

NGA ROBERT D. KAPLAN

Edhe pse imperializmi cilësohet sot, si një sistem i diskretituar, perandoria ka qenë mjeti i nënkuptuar i qeverisjes për shumicën e historisë, dhe kolapsi i perandorive ka qenë gjithmonë një punë e rrëmujshme, që nga Kina dhe India, nga antikiteti e deri në fillim të shekullit XX-të, ose në Evropë duke filluar nga Lufta e Parë Botërore.

Situata e vështirë që shohim sot në botën arabe, me një kaos në disa pjesë të Afrikës së Veriut, në Gadishullin Arabik dhe Levant, ka të bëjë në fakt me fundin e imperializmit. Pushtimi nga Shteti Islamik i Palmiras, një qytet i lashtë karavanësh, dhe një nga vendet më mahnitëse arkeologjike në Lindjen e Afërme, vetëm sa e përforcon këtë konstatim.

Palmira është shembulli, që rajoni historikisht ka qenë i përcaktuar nga rrugët tregtare, më tepër sesa nga kufijtë e ngurtë tokësorë. Pushtimi i saj nga barbarët, vetëm sa dëshmon sesi bota është rikthyer në atë realitet të paqëndrueshëm. Ak-

tualisht në Lindjen e Mesme, po shohim rrënimin e 3 sistemeve perandorake. Së pari, kaosi në Lindjen e Mesme tregon se rajoni ende nuk ka gjetur një zgjidhje, pas rënies së Perandorisë Osmane me mbarimin e Luftës së Parë Botërore. Për qindra vjet me radhë, sunitët dhe shiitët, arabët dhe hebrejtë, myslimanët dhe të krishterët, në Sirinë e Madhe dhe Mesopotami, patën mosmarrëveshje territoriale.

Të gjithë ranë nën sundimin e një sovrani perandorak në Stamboll, i cili i mbrojtë ata nga njëri-tjetri. Ai sistem u shemb në vitin 1918, duke çliruar nga kafazi “demonët” e mosmarrëveshjeve kombëtare, etnike, sektare, që grindeshin se kush kontrollon territorin e kujt, dhe në cilët kufij saktësisht. Së dyti, shpërthimi i dhunës civile në Irak pas rrëzimit të Sadam Hyseinit, shpërthimi i trazirave në Siri, pas të Pranverës Arabe, si dhe krijimi i Shtetit Islamik i ka dhënë fund kufijve të dikurshëm, të përcaktuar nga imperializmi evropian, britanik dhe francez në Levant.

Së treti, mbështetja vetëm e tërthortë ndaj këtyre zhvillimeve, nga ana e presidentit amerikan Barak Obama, dëshmon fundin e rolit të madh të Amerikës, si një fuqi e madhe në organizimin dhe stabilizimin e rajonit. Dhe këtu, duhet kujtuar se Shtetet e Bashkuara, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, kanë qenë një perandori botërore në çdo aspekt, përveç mungesës së emërtimit zyrtar. (Ndoshta askush, nuk merret më gjerësisht me këtë çështje të sikletshme, sesa historiani i Universitetit të Oksfordit, Xhon Darvin në librin e tij të vitit 2007: “Pas Tamerlanit: Ngritja dhe rënia e perandorive globale, 1400-2000”).

Dhe nuk janë vetëm forcat perandorake, ato që kanë rënë duke lënë pas kaosin. Rënia e Sadam Hyseinit në Irak, Muamar Gedaftit në Libi, dhe mpakja e regjimit të Bashar Al- Asadit në Siri, dëshmon se ka përfunduar epoka e njëzëzve të fortë të epokës post-koloniale, sundimi i të cilëve ishte i lidhur organikisht me trashëgiminë e imperializmit. Tek e fundit, ata diktatorë sunduan në bazë të kufijve të përcaktuar nga evropianët. Dhe për shkak se ata kufij perandorakë, shpesh nuk përputhen me ato etnikë ose sektarë, këto regjime diktatoriale kërkuan identitete laike, në mënyrë që të nxisnin ndarjet komunitare. E gjitha kjo çoi brutalisht shumë larg.

Mjerisht, e ashtuquajtura Pranvera Arabe, nuk kishte si synim lirinë, por rrëzimin e pushtetit qëndror, gjë që nuk thotë asgjë mbi gatishmërinë e këtyre shteteve, artificiale dhe ndryshe nga të tjerët, për masa të rrepta demokratike. Në mesin e shteteve të prekura nga përmbysja aktuale, dy lloje kanë qenë të dukshme.

Në të parin përfshihen vendet, që përfaqësojnë qytetërimet e vjetëra. Ka prej tyre, që kanë qenë shtete në një formë ose në një tjetër, duke përbërë një kthim prapa në antikitet, dhe në këtë mënyrë kanë evoluar format e guximshme të identitetit laik, që janë ngritur mbi etnitë dhe sektet fetare. Maroku, Tunizia dhe Egjipti, janë shembujt më të spikatur në këtë kategori.

Nëse dikush shikon në një hartë të vjetër të periudhës romake, përgjatë bregdetit të Afrikës Veriore do të vërejë se ajo është e mbushur me vendbanime ku janë vendosur këto vende, dhe relativisht mungojnë vendbanimet në hapësira të gjera në mes të Algjerisë dhe Libisë. Me fjalë të tjera, Maroku, Tunizia dhe Egjipti janë historikisht të caktueshëm.

Çfarëdolloj trazire dhe ndryshimi, që kanë përjetuar gjatë Pranverës Arabe, identitetet e tyre si shtete, nuk janë vënë asnjëherë në diskutim. Për rrjedhojë, çështja në këto vende kanë qenë mbi atë se kush sundon dhe se çfarë lloj qeverisje duhet të jetë, dhe jo në lidhje me nëse janë apo jo një qeveri shtetërore apo qendrore.

Grupi i dytë i shteteve të Lindjes së Mesme, është edhe më i paqëndrueshëm. Këto vende marrin formën e shprehjeve të paqarta gjeografike, dhe bartin identitete shumë më të dobëta - dhe, në fakt, shumë prej tyre kanë identitete, që janë shpikur nga imperialistët evropianë. Libia, Siria dhe Iraku, përfshihen më dukshëm në këtë kategori.

Sepse identiteti në këto raste ishte i brishtë, dhe kërkoheshin format më mbytëse të autoritarizmit për t'i mbajtur këto shtete të bashkuara. Është kjo origjina e natyrës ekstreme të rregjimeve të Gedafit, Asadit dhe Hyseinit, të cila praktikonin nivele shtypjeje shumë më të rënda, sesa rregjimi i Hosni Mubarakut në Egjipt dhe Zine Al-Abidine Ben Alisë në Tunizi.

Algjeria, që gjithashtu është një shtet artificial, në thelb i shpikur nga francezët, ka përjetuar sundimin e largët dhe autoritar, dhe tani përballet me një tranzicion të pasigurtë, duke patur parasysh shëndetin e përkeqësuar të sundimtarit të saj, Abdel Aziz Buteflika, i cili ndodhet në pushtet prej vitit 1999.

Jordania gjithashtu, është një shprehje e paqartë gjeografike, por që ka gëzuar një qeverisje të moderuar, falë gjenialitetit të monarkisë Hashemite në pushtet, dhe mbështetjes së madhe ekonomike dhe sigurisë, që ky vend i vogël ka marrë nga Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli.

Ndërkohë edhe Jemeni, mund të përfshihet gjithashtu në grupin e qytetërimeve të vjetra, por gjithmonë i ndarë ndërmjet mbretërive të ndryshme. Për shkak të topografisë së tij të përthyer, qeverisja e territorit si një njësi e vetme, ka qenë përherë gati e pamundur. Vetëm rregjimet totalitare mbytëse, mund t'i kontrollojnë këto vende artificiale, të formuara nga shprehje të paqarta gjeografike.

Kur këto regjime u shembën, lanë pas një zbrazëti të plotë.

Midis regjimit në krye, dhe fisit dhe familjes së zgjeruar në fund, të gjitha format e ndërmjetme të organizimit shoqëror dhe politik, e kishin humbur kuptimin e tyre shumë kohë para se regjime të tilla të vinin në pushtet. Totalitarizmi, ishte e vetmja përgjigje për t'i dhënë fund imperializmit perëndimor në këto shtete artificiale, dhe rënia e totalitarizmit, është tanimë shkak kryesor i kaosit në Lindjen e Mesme.

Mbulimi i kësaj rrëmuje shprehjesh të paqarta gjeografike, dhe dobësimi i grupeve të vjetra të qytetërimit, ka qenë rritja e fuqive indigjene rajonale të tilla si Irani, Turqia dhe Arabia Saudite.

Irani nga njëra anë është një qytetërim i madh dhe ndër më të vjetërit në botë, dhe nga ana tjetër një nën-shtet i pamëshirshëm dhe i radikalizuar. Kjo është ajo që ka rëndësi, për efektivitetin e saj dinamik në mbarë rajonin.

Një perandori Perse, ka qenë e bazuar në një formë apo në një tjetër në platenë iraniane të antikitetit. Kështu, në vend se të përballet me probleme të identifikimit politik si arabët, iranianët janë të bekuar nga një vetë-siguri kulturore, e krahasueshme me atë të Indisë dhe Kinës. Megjithatë, në të njëjtën kohë, Kuvendi i ngushtë i mullahëve radikalë në drejtimin e qeverisë së Teheranit, përfaqëson një nën-shtet të ngjashëm me grupet e xihadistëve, sikurse dhe është Shteti Islamik, Hezbollahu, Al-Kaeda dhe ish- ushtria Mahdi.

Kështu Irani, është në gjendje të veprojë me dhunti të pazakonta. Ai zotëron tashmë ciklin e karburantit bërthamor, trupa të trajnuara radikale dhe të mirëarmatosura në Levant, dhe menaxhoi shkëlqyeshëm negociatat me kundërshtarin e tij kryesor, Shtetet e Bashkuara, për programin e tij bërthamor. Kështu Irani ka trashëguar pjesërisht, boshllëkun e lënë nga zhdukja e osmanëve, evropianëve, dhe perandorive amerikane.

Ndërsa Irani, është nyja shiite e pushtetit në Lindjen e Mesme sërish sektare, Arabia Saudite është nyja sunite. Në krahasim me Iranin, Arabia Saudite, është krijimi artificial i një familje të vetme të zgjeruar. Vendi që qeveris familja, nuk përputhet territorialisht me Gadishullin Arabik, deri në masën që Irani i sotëm përputhet me Persinë e dikurshme. Sidoqoftë, Dhoma e Saudëve, ka shenjuar jo pa lënë përshtypje, rrugën e saj përgjatë dekadave, përmes shndërrimit të madh social në vend dhe në një situatë të trazuar të sigurisë jashtë vendit.

Dhe ndryshimet e fundit në nivelet e larta drejtuese nga mbreti i ri Salman, duke përfshirë edhe zëvendësimin e Princit të Kurorës dhe Ministrin e Jashtëm, tregon për përcaktimin absolut të kësaj dinastie, për të rregulluar politikën e saj në një

mënyrë të tillë, që të mos lejojë dominimin e Iranit në rajon.

Fushata e fundit ajrore e Arabisë Saudite kundër fisit Huthi në Jemen, të mbështetur nga Irani, dhe intensifikimi i përtërirë i mbështetjes për rebelët anti-iranianë sirianë (ndihmuar edhe nga Turqia dhe Katari), është një reagim ndaj asaj që Riadi sheh si një marrëveshje të afërt bërthamore amerikano-iraniane.

Në të vërtetë, sauditët tashmë po faktorizohen sipas llogaritjeve të tyre, për shkak të mundësisë së madhe të një marrëveshje të tillë. Dhe bombardimi në Jemen, si dhe presioni i fundit mbi regjimin pro-iranian të Asadit në Siri, përfaqësojnë në thelb zhvillimet e post marrëveshjes bërthamore në Lindjen e Mesme. Kjo marrëveshje, në rast se ndodh, edhe pse e kufizuar tek çështjet bërthamore, do të shihet me një farë justifikimi, si fillimi i një lloj afrimi më të përgjithshëm amerikano-iranian: në aspektin rajonal, përbën një rënie të fuqisë perandorake, me rritjen e fuqive indigjene.

Për të përmbajtur situatën post- marrëveshjes me Iranin, Shtetet e Bashkuara do të duhet jo vetëm të forcojnë pozitat e Arabisë Saudite, por edhe Egjiptin dhe Turqinë. Shërbimet e sigurisë të Egjiptit, nën njeriun e plotfuqishëm të ushtrisë Abdel Fatah El-Sisi, tashmë janë aleate në heshtje me shërbimet e sigurisë izraelite në Gaza, Sinai, dhe gjetkë.

Amerika dëshiron një Egjipt të fortë - demokratik apo jo - si një aleat rajonal kundër Iranit, për të forcuar Arabinë Saudite. Ndërsa Turqia, nën presidentin Rexhep Taip Erdogan, nuk është parë zakonisht si një vend pro-amerikan. Gjithësesi një Turqi e fortë në vetvete, gjithashtu ndihmon në ekuilibrin kundër pushtetit iranian. Ndeshja midis këtyre fuqive gjeografikisht dhe historikisht me fat në raport me dominimin rajonal, do të përcaktojë rendin e ri post-perandorak.

Një president i ri amerikan në vitin 2017, mund të kërkojë të rivendosë ndikimin perandorak perëndimor, natyrisht duke e quajtur atë me një emër tjetër. Por, ai ose ajo do të kufizohet nga kolapsi i madh i autoritetit qëndror në të gjithë Lindjen e Mesme, që filloi me rënien e Sadam Hyseinit dhe vazhdoi përgjatë viteve të post-Pranverës Arabe.

Diktaturat e forta arabe anembanë rajonit, ishin të përshtatshme për interesat amerikane, përderisa ato i jepnin SHBA-së një adresë të vetme, për të shkuar në çdo rast të krizave rajonale. Por tani ka shumë pak nga ajo. Në disa vende, thjesht nuk është askush në krye, për t'i shprehur shqetësimet tona. Kaosi nuk është vetëm një problem sigurie dhe çështje humanitare, por një pengesë e rëndë për projektimin e fuqisë amerikane.

Kështu, në terma afat-shkurtër dhe ndoshta afat-mesëm, e ardhmja e Lindjes së Mesme, ka të ngjarë të jetë e zyrtë. Shteti Islamik sunit, do të luftojë tani milicite shiite të Iranit, ashtu si sunitët në Irak në kohën e Sadamit, luftuan Iranin shiit të Ajatollah Khomeinit, gjatë luftës së përgjakshme Irak- Iran në viteve 1980-1988.

Ajo luftë, për aq sa zgjati, përfaqësoi pjesërisht vendimin e qëllimshëm të administratës së presidentit Reganit për të mos ndërhyrë - një shembull tjetër i autoritetit të dobët perandorak, edhe pse disi i suksesshëm, pasi i lejoi Reganit të përqëndrohet në Evropë dhe ndihmojë t'i japë fund Luftës së Ftohtë.

Asokohe kishim të bënim me një luftë mes shtetesh, tashmë është një konflikt nën- shtetesh. Imperializmi vendosi rregull, sado reaksionar që mund të ketë qenë. Sfidat tashmë është më pak për të vendosur demokracinë, sesa për të rivendosur rendin. Pasi pa rend, nuk ka liri për askënd.

“Foreign Policy”